

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

Pnr. 54/2014

18 nëntor 2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS, në Trupin Gjykes të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Roxana Comsa si Kryetare e Trupit Gjykes, Gjyqtari i EULEX-it Nuno Madureira dhe Gjyqtari i EULEX-it Arkadiusz Sedek si anëtarë të Trupit Gjykes, me zyrtaren ligjore të EULEX-it Vera Manuello si procesmbajtëse në çështjen penale:

Kundër:

R.H. , emri i babait K., emri i nënës H., mbiemri i vajzërisë H., i lindur më _____ në fshatin _____, Komuna e _____, i pensionuar, me vendbanim në rrugën _____, Komuna e _____, shqiptar i Kosovës, i martuar, ka shtatë fëmijë të rritur, me gjendje ekonomike mesatare, në paraburgim nga data 22 nëntor 2010 deri më 11 nëntor 2011, në arrest shtëpiak nga data 11 nëntor 2011 deri më 27 mars 2012 dhe prapë në paraburgim pas kësaj kohe;

I akuzuar për:

Vrasje, në kundërshtim me nenin 146 të KPK-së/Akuza1/; Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (1) të KPK-së/Akuza 2/; Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) /Akuza 3/

Duke konsideruar si në vijim: me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 26 mars 2013, në të cilin Aktgjykimi (i atëhershëm) i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P. nr. 11/2011, i datës 26 mars 2012, në lidhje me aktin penal të Vrasjes sipas nenit 146 të KPK-së /Akuza1/ anulohet dhe çështja kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë; me anë të të njëjtit aktvendim nga Gjykata e Apelit të Kosovës të datës 26 mars 2013 i

akuzuari është dënuar me një/1/vit burgim për veprën penale Mbjajtje në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së. - /Akuza 3/; Lirimi i të pandehurit për akuzën Mbjajtje në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (1) të KPK-së/Akuza 2/ mbetet e njëjtë nga Gjykata e Apelit.

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në rigjykim nga data 17 deri 20 qershor 2013, më 15 dhe 16 korrik 2013, më 29 dhe 30 korrik 2013, në praninë e të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës dhe prokurores Neeta Amin. Pala e dëmtuar **Z.D.** ishte e pranishme gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, të datave 17, 18, 19 dhe 20 qershor dhe më 20 dhe 30 korrik 2013. Seancat e shqyrtimit gjyqësor kanë qenë të hapura për publikun.

Pasi që Gjykata Themelore e Mitrovicës kishte nxjerrë një Aktgjykim më 30 korrik 2013, në të cilin i pandehuri u shpall fajtor dhe u dënua me 8/tetë/vjet burgim, me të cilin rikonfirmonte Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 26 mars 2013 në të cilin i akuzuari ishte dënuar me 1/një/vjet burgim për veprën penale të Mbjajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së - /Akuza 3/, dënimi unik për veprat penale sipas Akuzës 1 dhe Akuzës 3 ishte caktuar në 8/tetë/vjet e 3/tre/muaj burgim, bazuar në nenin 71 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) pika 2 të KPK-së;

Pasi që Gjykata e Apelit të Kosovës lëshoi një vendim të datës 14 mars 2014 në të cilin Gjykata e Apelit e anuloi Aktgjykimin të Gjykatës Themelore të Mitrovicës të datës 30 korrik 2013 dhe e ktheu çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim:

Pasi që ka mbajtur seancat e rigjykimit për shqyrtimin e dytë më 11 gusht 2014, këqyrja e vendit të ngjarjes më 13 gusht 2014, dhe seancat e mbetura të rigjykimit më 16 tetor 2014 dhe 13 nëntor 2014 në praninë e të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës dhe prokurores Neeta Amin. Pala e dëmtuar, **Z.D.**, ishte pjesërisht i pranishëm gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes. Seancat e shqyrtimit gjyqësor kanë qenë të hapura për publikun;

Pas këshillimit dhe votimit të Trupit Gjykues më 18 nëntor 2014;

Sipas nenit 392 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), publikisht e ka shpallur në prani të të pandehurit, avokatit Mahmut Halimi, palës së dëmtuar dhe prokurores;

Sipas neneve 388 – 391 të KPPK-së;

Shpall këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **R.H.**, të dhënat personale si më lart,

shpallet

FAJTOR

Sepse me 18 nëntor 2010 rreth orës 10:45 ne vendin e quajtur Ura e Gjakut ne Mitrovice ai e ka privuar nga jeta **M.D.** duke e sulmuar atë me thikë dhe duke e therur atë tetë here me thikë ne pjesë të ndryshme të trupit, duke e shkaktuar një plagë të therjes me thikë në krahun e majtë, një plagë të therjes me thikë në abdomen, dy plagë të therjes me thikë në trung dhe katër plagë të therjes me thikë ne gjoks. Si rezultat i njërës nga therjet me thikë në gjoks, duke e dëmtuar zemrën e tij, **M.D.** ka vdekur gjatë rrugës për në klinikë në Mitrovicë.

R.H., duke e therë me thikë në gjoks **M.D.** mjaftueshëm ka paraparë se veprimi i tij ka mund të rezultojë në vdekjen e këtij të fundit dhe këtë e ka pranuar.

R.H. ka qenë mendërisht plotësisht i aftë.

Duke vepruar kështu, **R.H.** ka kryer dhe është përgjegjës penalisht për aktin penal te Vrasjes në shkelje të nenit 146 te KPK, lidhur me nenin 11, 12, dhe 15 (3) KPK. – /Akuza 1/

PRANDAJ, i akuzuari R.H. DËNOHET

me 8 /tetë/ vjet burgim për veprën penale të Vrasjes në shkelje të nenit 146 të KPK-së.

Sipas nenit 12 dhe nenit 3 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.2.5) të Ligjit për Amnistinë (Ligji nr. 04/L-209) të datës 11 korrik 2013, të shpallur me Dekretin nr. DL-051-2013 të datës 17 shtator 2013 që ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, i pandehuri lirohet nga ekzekutimi i dënimit prej 1/një/viti burgim të zbatuar me Aktvendim të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 26 mars 2013 për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së. - /Akuza 3/.

Koha e kaluar në paraburgim ndërmjet 22 nëntor 2010 dhe 11 nëntor 2011, dhe ndërmjet 27 mars 2012 dhe 30 korrik 2013 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga 11 nëntor 2011 deri me 27 mars 2012 dhe nga 30 korrik 2013 deri në ditën e sotme do të llogaritet sipas nenit 73 paragrafët (1) dhe (4) të KPK-së.

I akuzuari duhet t'i paguajë katërqind (400) Euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale, por ai lirohet nga detyrimi të paguajë shpenzimet tjera sipas nenit 102 paragrafët (1) dhe (4) të KPK-së.

ARSYETIMI

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Prokurori (i atëhershëm) Publik i Qarkut nga Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë me 15 shkurt 2011 ka ngritur Aktakuzë kundër të akuzuarit duke e akuzuar atë për kryerje të veprave penale të Vrasjes sipas nenit 146 të KPK-së. /Akuza 1/. Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (1) të KPK-së/Akuza 2/ dhe Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së/Akuza 3/. Aktakuza është vërtetuar me Aktvendim nr. KA nr. 06/11 të Gjykatës (se atëhershme) së Qarkut të Mitrovicës me datën 25 shkurt 2011.

2. Më 26 mars 2012 Gjykata (e atëhershme) e Qarkut të Mitrovicës ka marrë Aktgjykim duke e shpallur të pandehurin fajtor dhe penalisht përgjegjës për dy akuza, kryesisht për veprën penale të Vrasjes sipas nenit 146 të KPK-së /*Akuza 1/* dhe për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së/*Akuza 3/*. I pandehuri është dënuar me 8 vjet burgim për kryerje të Akuzës 1 dhe 2 vjet burgim për kryerje të Akuzës 2; dënimi unik ka qenë i përcaktuar në 9 vjet burgim; I pandehuri është liruar për akuzën e Mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (1) të KPK-së/*Akuza 2/*
3. Me Aktvendim të Gjykatës së Apelit të Kosovës Aktvendimi i Gjykatës së (atëhershme) të Qarkut në Mitrovicë P. nr. 11/2011 të datës 26 mars 2012 është anuluar dhe lënda është kthyer për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë në lidhje me veprën penale të Vrasjes sipas nenit 146 të KPK-së /*Akuza 1/*; me Aktvendim të njëjtë të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 26 mars 2013 i akuzuari është dënuar me 1 /një/ vit burgim për veprën penale Mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së/*Akuza 3/* Lirimi i të pandehurit nga akuza e Mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi (1) të KPK-së/*Akuza 2/* ka mbetur e njëjtë nga Gjykata e Apelit.
4. Seancat e shqyrtimit gjyqësor të rigjyqimit janë mbajtur prej 17 deri më 20 qershor 2013, me 15 dhe 16 korrik 2013, me 29 dhe 30 korrik 2013. Aktgjykimi është shpallur me 30 korrik 2013 konform dispozitivit të lartpërmendur.
5. I pandehuri u gjet fajtor dhe ishte penalisht përgjegjës për veprën penale të Vrasjes sipas nenit 146 të KPK-së /*Akuza 1/* dhe u dënuar me 8 vjet burgim për kryerje të veprës nga Akuza 1. Dënimi unik mes këtij dhe 1 viti burgim sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 26 mars 2013 për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkeljes së

nenit 328 paragrafi (2) të KPK-së. - /Akuza 3/ - ishte caktuar në 8 vjet e 3 muaj burgim.

6. Ndaj Aktgjykimit sërish ishte ushtruar ankesë dhe në vendimin e datës 14 mars 2014, Gjykata e Apelit e kishte kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim edhe një herë të akuzës së Vrasjes sipas nenit 146 i KPK-së /Akuza 1/.

II. KODI I PROCEDURËS

7. Më 1 janar 2013 Kodi i ri i Procedurës ka hyrë në fuqi në Kosovë. Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123) (KPP) i cili ka zëvendësuar Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale (të ndryshuar) (Rregulloren e UNMIK-ut 2003/26) KPPPK)) (Nenet 545(2) dhe 547 të KPP). Dispozitat tranzitore dhe të ruajtura aplikohen që përcaktojnë aplikimin e procedurës sipas KPP-së dhe aplikimi i vazhdueshëm i KPPK-së në rrethana specifike. Sipas Mendimit Ligjor të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të lëshuar nën nr. 56/ 23 janar 2013, në procedurat penale të iniciuara para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës për të cilat shqyrtimi gjyqësor tashmë ka filluar, por që nuk (janë) është kompletuar por që janë kthyer për rigjykim me mjete të zakonshme apo të jashtëzakonshme ligjore, dispozitat e Kodit të vjetër do të aplikohen *mutatis mutandis* deri atëherë kur vendimi të merr formën e prerë.

III. KOMPETENCA

8. Ligji mbi Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199 (LGJ)) gjithashtu ka hyrë plotësisht në fuqi më 1 janar 2013 (neni 43). Ky Ligj e rregullon kompetencën territoriale dhe lëndore të gjykatave.
9. Vepra penale bie brenda kompetencës territoriale dhe lëndore të Gjykatës Themelore të Mitrovicës (para 1 janarit 2013 dhe Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë). Për veprën

penale të Vrasjes parashihet dënimi prej së paku 5 vjet dhe bie nën çështjen në fjalë të kompetencave të Gjykatës Themelore në shkallën e parë (shiko nenin 23 paragrafi (1) nën-paragrafi (i) i KPPK dhe nenin 15 paragrafët (1.11) dhe (1.21) të LGJ). Meqë Aktakuza pretendon se vepra është kryer në vendin e quajtur "Ura e Gjakut", fshati Shipol, Komuna e Mitrovicës, ajo bie brenda kompetencës territoriale të Gjykatës Themelore të Mitrovicës sipas nenit 29 paragrafi (1) të KPPK-së dhe nenit 9 paragrafi (2.7) të LGJ.

10. Në pajtim me nenin 3.3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it ("Ligji mbi Kompetencat"), gjyqtarët e EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë janë caktuar në lëndë me vendim të Presidentit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it të datës 15 qershor 2011.
11. Nuk pati kundërshtime në lidhje me përbërjen e trupit gjykues¹.

IV. PROVAT E PREZANTUARA

12. Në procedurat e tanishme, trupi gjykues vendosi që t'i konsiderojë si të lexuara deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar në rigjykimin e fundit dhe ato konsiderohen si të lexuara në rigjykimin e fundit dhe kjo bazuar në faktin se palët u pajtuan. Po ashtu, neni 429 paragrafi 3 i KPPK-së parasheh që gjykata e shkallës së parë ndërmerr të gjitha veprimet procedurale dhe shqyrton të gjitha çështjet kontestuese të theksuara në vendimin e gjykatës së shkallës së dytë:

Në rastin tonë Gjykata e Apelit ka konstatuar se kontestohen dy aspekte dhe kishte rekomanduar në mënyrë specifike kryerjen e një super ekspertize dhe rikonstruim/vizitë në vend të ngjarjes. U konsiderua se nuk ka nevojë të dëgjohet asnjë dëshmitarë. Trupi gjykues konsideroi se përmes përshtatjes së kësaj zgjidhjeje përmbushet edhe parimi i menjëhershmerisë, pasi që trupi gjykues është në përbërje

¹ Procesverballi i seancës së shqyrtimit gjyqësor 11 gusht 2014, faqe 2 versioni anglisht;

të njëjtë sikurse herën e kaluar dhe atëherë e kishte pasur mundësinë që t'i shqyrtonte në mënyrë të drejtpërdrejt provat. Kjo ishte pa prejudikuar nenin 429 paragrafi 3 që u jep të drejtë palëve që të paraqesin prova të reja².

13. Andaj, trupi gjykues i konsideroi si të lexuara në procesverbal dëshmitë e mëposhtme:

Dëshmitë e dëshmitarëve dhe të dëshmitarëve ekspertë të dëgjuar gjatë rigjyimit të parë:

- **Z.D.** – me 17 qershor 2013;
- **A.D.** – me 18 qershor 2013;
- Zyrtari i PK **R.P.** – me 18 qershor 2013;
- Zyrtari i PK **S.S.** – me 18 qershor 2013;
- **S.M.** – me 19 qershor 2013;
- **E.Sh.** – me 19 qershor 2013;
- **H.D.** – me 19 qershor 2013;
- Zyrtari i PK **H.B.** – me 19 qershor 2013;
- Zyrtari i PK **Rr.M.** – me 20 qershor 2013
- Zyrtari i PK **G.K.** – me 20 qershor 2013;
- Zyrtari i PK **F.Sh.** – me 20 qershor 2013;
- **A.H.** – me 20 qershor 2013;
- Dëshmitari Ekspert **Z.M.** – me 15 korrik 2013
- Dëshmitari Ekspert **C.B.** – me 15 korrik 2013;
- Dëshmitari Ekspert **M.G.** – me 16 korrik 2013;
- Dëshmitari **A.K.** - me 16 korrik 2013.
- Dëshmitë e dëshmitarëve dhe të dëshmitarëve ekspertë janë konsideruar si të lexuara gjatë rigjyimit të parë:
- Dëshmia e dëshmitarit ekspert **M.G.** të dhënë gjatë gjyqimit të parë kryesor me 2 mars 2012.³;

² Procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor 11 gusht 2014, faqe 4 versioni anglisht;

³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 18 qershor 2013;

- Dëshmia e dhënë nga **Xh.I.** para Gjykatës me 16 mars 2012⁴;
- Dëshmia e dhënë para Gjykatës nga **B.A.** me 16 mars 2012⁵.

14. Përveç atyre që u cekën më lart dëshmitarët e mëposhtëm ekspertë janë dëgjuar në kuadër të procedurave të tanishme: Dr. **F.B.** dhe Dr. **M.G.**.

15. Vizita në vendin e ngjarjes ishte kryer më 13 gusht 2014⁶.

16. Objektivat e tij u caktuan nga trupi gjykues me Aktvendimin e vet me gojë të datës 11 gusht 2014. Me të njëjtin Aktvendim, objektivat e tjerë të propozuar nga mbrojtja u refuzuan si jo relevant⁷.

17. Provat e mëposhtme të prezantuara dhe ekzaminuara më parë gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor konsiderohen si prova:

- Një helmete, me numër identifikues 2010/179, prova 1, e datës 18 qershor 2013;
- Një thike, prova 2, të datës 18 qershor 2013;
- Një fotografi e vendit të ngjarjes (me dëshmitarin e dyqanit të shënuar me X) prova 3, të datës 19 qershor 2013;
- Një fotografi të vendit të ngjarjes (me pozicionin e dëshmitarit **H.D.** të shënuar me X) prova 4 e datës 19 qershor 2013;
- Informata të mjekësisë ligjore mbi patologjinë plagëve nga thika, prova 5, e datës 15 korrik 2013;
- Raporti mjekësor i datës 22 Nëntor 2013, prova 6, e datës 15 korrik 2013;

⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 qershor 2013;

⁵ Procesverbali i i shqyrtimit gjyqësor 19 qershor 2013;

⁶ Procesverbali i vizitës së vendit të ngjarjes 13 gusht 2014 dhe Shtojca në të ;

Mbi një çështje të vogël procedurale dhe teknike, gjykata vëren shqetësimin e paqëndrueshëm të prokurores në fjalën e saj përfundimtare e cila nuk është pasqyruar nga pranimi i saj i më pastajmë i procesverbalit të shqyrtimit. Është e parregullt që të ngriten shqetësime të reja procedurale në një fjalë përfundimtare kur ka pasur mundësi të mjaftueshme dhe të konsiderueshme për ta ngritur atë shqetësim gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor dhe që ato të shprehen në mbyllje të procedurës së paraqitjes së provave, siç ka ndodhur në këtë rast. Do të ishte e padrejtë dhe e parregullt që atë ta trajtojmë si ndonjë gjë, por duhet ta trajtojmë si vlerësim të paqëndrueshëm të prokurores. Ky shqetësim nuk ka rrjedhoja sa i përket drejtësisë ose integritetit të vendimit të gjykatës;

⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 11 gusht 2014, faqe 8 versioni anglisht;

- Një listë e provave materiale të prezantuara nga prokurori, prova 7, e datës 29 korrik 2013;
- Rrobat e të pandehurit, numrat 7.1, 7.2, 7.4 dhe 7.8⁸, të datës 29 korrik 2013.

18. Ngjashëm, me pajtim të ndërsjellë, dokumentet ne vijim janë pjesë e procesverbalit:

- Dosja e shkresave të lëndës 1: hetime dhe prova
- Raporti kriminal-numri i lëndës 2010 BC1284 – Kërcenim, të datës 2 shtator 2010, faqe 60-63; Raporti fillestar i incidentit-nr. lëndës 2010-BC-1284, të datës 24 gusht 2010, koha 14:10h, faqe 64-67;
- Përgjigja e kuvendit Komunal të datës 3 gusht 2010, faqe 68-69;
- Kërkesë për Shkuarje ne Vendin e Incidentit për Kuvendin Komunal të datës 3 gusht 2010, faqe 70-71;
- **M.D.**, Procesverbal mbi marrjen në intervistë e dëshmitarit i datës 24 tetor 2010, faqe 283-286; Zyrtari policor **S.A.**, numri i rangut 1226, raporti i datës 24 gusht 2010, faqe 72-73;
- Shënim zyrtar i numrit të lëndës 2010-BC-1284 i datës 24 gusht 2010, faqe 74-75;
- Procesverbal mbi bastisjen e lokaleve të datës 24 gusht 2010, në ora 17.45, faqe 87-90;
- Certifikatë mbi artikujt e konfiskuar të datës 24 gusht 2010, në ora 18.30, faqe 91-92; Raporti mjeko-ligjor, numri i lëndës 2010-BC-1284 i datës 23 nëntor 2010, faqe 93-95;
- Raporti forenzik-numri i lëndës. 2010-BC-429 Vrasje, i datës 22 nëntor 2010, faqe 96-99;
- Memorandum Zyrtar –Lënda e Transferuar 2010-BC-1859 në RIU, i datës 19 nëntor 2010, faqe 100-101;
- Nr. i lëndës i raportit fillestar 2010-BI-429 i datës 18 nëntor 2010 në ora 10.45h, faqe 108-109;
- Orari i zyrtarit policor i datës 18 nëntor 2010 në ora 10.49;

⁸ Dengu 1 i shkresave të lëndës së prokurorisë 1, faqe 217;

- Memorandum zyrtar – Lënda e transferuar 2010-Bc-1284 në RIU i datës 23 nëntor 2010, faqe 110-111;
- Nr. i raportit të përcjelljes së lëndës F2010-BC-1284 i datës 2 shtator 2010, page 112-113;
- Raporti i Zyrtarit – (**Sh.F.** KP # ___) Lënda Nr-BI-429 i datës 18 nëntor 2010 në ora 19:00 , faqe 114-155;
- Raporti i Zyrtarit – (**S.S.** KP #___) Lënda nr. -BI-429 i datës 18 Nëntor 2010 në ora 13.20, faqe 116-119;
- Raporti i Zyrtarit– (**F.Sh.** KP #___) nr. i lëndës -BI-429 i datës 18 nëntor 2010 ne ora 13.00, faqe 120-121;
- Raporti policor nga vendi i incidentit (**Rr.M.** Kp#___) i datës 18 nëntor 2010, faqe 122-123;
- Raporti i zyrtarit (**L.S.** KP# ___) nr. i lëndës -BI-429 i datës 18 nëntor 2010 ne ora 14.00, faqe 124-125;
- Certifikatë mbi konfiskimin e artikujve i datës 18 nëntor 2010, faqe 126-127;
- **A.K.**, Procesverbal mbi marrjen në intervistë e dëshmitarit i datës 20 Nëntor 2010 ne ora 13.10, faqe 141-146;
- **A.H.**, Procesverbal mbi marrjen në intervistë e dëshmitarit i datës 23 Nëntor 2010 ne ora 13.30, faqe 147-152;
- **A. K.**, Procesverbal mbi marrjen në intervistë e dëshmitarit i datës 9 shkurt 2011 në ora 12.50, faqe 153-156;
- **Z.D.**, Procesverbal mbi marrjen në interviste e dëshmitarit i datës 14 janar 2011 në ora 12.00, faqe 157-162;
- **A.H.**, Procesverbal mbi marrjen në intervistë e dëshmitarit i datës 9 shkurt 2011, në ora 12.50, faqe 173-176;
- Raporti mbi ekzaminimin mjeko-ligjor të vendit të ngjarjes-nr. i lëndës 2010-BI-429, i datës 18 nëntor 2010 në ora 11.15, faqe 181-192;
- Kërkese për ekspertizë balistike- nr. i lëndës. 2010-BC-1284 i datës 28 nëntor 2010, faqe 192-194;
- Urdhër për Laboratorin e PK i datës 30 dhjetor 2010, faqe 195-196;

- Kërkese për ekspertize balistike- nr. i lëndës. 2010-BC-1284 i datës 7 dhjetor 2010, faqe 197-198;
 - Kërkese për ekspertizë/analiza te provave në laboratorin kryesor të datës 7 dhjetor 2010, faqe 199-200;
 - Urdhër për laborator të krimeve të PK-nr. i lëndës 2010-BC-1284 i datës 9 dhjetor 2010, faqet 201-202;
 - Urdhër për autopsi-nr. i lëndës -BI-429 i datës 18 Nëntor 2010, faqe 203-204;
 - Procesverbal nga mjeku specialist-nr. i lëndës -BI-429 i datës 18 nëntor 2010, faqe 205-206;
 - Raporti i mjekësisë ligjore, nr. i lëndës -BI-429 i datës 19 nëntor 2010, faqe 207-210;
 - Raport mbi autopsinë, nr. i lëndës No-BI-429 i datës 19 nëntor 2010, faqe 211-212 ;
 - Dosje e mjekësisë ligjore, faqe 213-214;
 - Raport shtese i mjekësisë ligjore i datës 22 nëntor 2010 në ora 09.30, faqe 215-218;
 - Foto- Album, nr. i lëndës -BI-429 i datës 19 nëntor 2010, faqe 220-235;
 - Raport mbi autopsinë, nr. i lëndës -BI-429 i datës 19 nëntor 2011 në ora 10.30- 13.00, faqe 236-253;
 - Lisat e lëshimit nga spitali i të dyshuarit i datës 22 nëntor 2010, faqe 254-256;
 - Foto album i datës 22 nëntor 2010;
 - Raport i PK (V.Sh. Kp #___) i datës 18 nëntor 2010 faqet 269;
 - Dosje mjekësisë ligjore , faqe 270-271;
 - Raport i Klinikës Universitare i datës 18 nëntor 2010 në ora 14.30, faqe 272-275;
 - Skice e lokacionit të incidentit, nr. i lëndës No-BI-429 i datës 18 nëntor 2010, faqe 276;
 - Tabele e masave te lokacionit te incidentit i datës 18 nëntor 2010, faqe 277;
 - Foto album (vendi i incidentit) Nr. i lëndës -BI-429 i datës 18 nëntor 2010;
 - Foto e bastisjes se shtëpisë se dyshuarit i datës 18 gusht 2010, faqe 278-280;
 - Raport i mjekësisë ligjore i datës 21 dhjetor 2010, faqe 281-282.
- Dosja 2; Procesverbal mbi gjykimin fillestar

- Aktvendim i Gjykatës se Apelit për anulimin e Aktgjykimit P.nr. 11/2011 dhe për dërgimin e lëndës për rigjykim, 26 mars 2013, faqe 01-11;
- Aktgjykim P. Nr. 11/2011, 26 mars 2012, faqe 12-54;
- Ankese e avokatit mbrojtës Mahmut Halimi kundër Aktgjykimit P. nr. 11/2011, 9 korrik 2012, faqe 55-86;
- Mendimi i DPPPO Mitrovica mbi ankesën , 27 korrik 2012, faqe 87-96;
- Fjala përfundimtare e Prokurorisë—**R.H.** 22 mars 2012, faqe 97-131;
- Fjala përfundimtare e avokatit mbrojtës, 22 mars 2012, faqe 132-156;
- Procesverbal i shqyrtimit kryesor i datës 21 shkurt 2012, faqe 157-208:
- **Z.D.**-palë e dëmtuar (djali i të ndjerit), faqe 161-173;
- Dëshmitari **A.K.**, faqe 173-181;
- **A.D.** - vëllai i palës së dëmtuar (vëllai i të ndjerit), faqe 183-188;
- Dëshmitari **A.K.**, ri-thirrur, faqe 188-189;
- Ballafaqimi i **A.D.** dhe **A.K.**, faqe 190-191;
- Dëshmitari **A.H.**, faqe 181-207;
- Procesverbal i Gjykimit Kryesor 22 shkurt 2012, faqe 209-222:
- Dëshmitari **R.P.**-zyrtar i policisë, faqe 213-222;
- Procesverbal i shqyrtimit kryesor 23 shkurt 2012, faqe 223-255;
- Dëshmitares **S.S.**- zyrtar i policisë, faqe 224-234;
- Dëshmitari **H.B.**-zyrtar i policisë, faqe 234-239;
- Dëshmitari **S.M.**, faqe 239-251;
- Procesverbal i shqyrtimit kryesor 2 mars 2012, faqe 256-299:
- Dëshmitari **Rr.M.**- zyrtar i policisë, faqe 258-266;
- Dëshmitari **G.K.**-zyrtar i policisë, faqe 266-268;
- Dëshmitari ekspert **Z.M.**-oftalmolog, faqe 269-276;
- Dëshmitari ekspert **M.G.**-mjek emergjent, faqe 277-283;
- Dëshmitari **E.Sh.**, faqe 283-297;
- Procesverbal i Gjykimit Kryesor (Anglisht-Shqip) 12 mars 2012, faqe 300-312;
- Procesverbal i Gjykimit Kryesor 16 mars 2012, faqe 313-335:
- Dëshmitari **F. Sh.**- zyrtari i policisë, faqe 314-323;

- Dëshmitari **B.A.**, faqe 323-326;
- Dëshmitari **H.D.**, faqe 326-328;
- Dëshmitari **Xh.I.** faqe 328-330;
- Deklaratat e **Xh.S.** të dhëna e para PPQ të deklaruara si të papranueshme, faqe 332;
- Procesverbal i shqyrtimit kryesor 22 mars 2012, faqe 336-358;
- Dëshmitari ekspert **C.B.**-ekspert i forenzikës , faqe 342-352;
- Provat e prezantuara 7.1, 7.4 dhe 7.5, 7.3, faqe 353-355;
- Ekzaminimi i te akuzuarit - leximi i deklaratave të dhëna nga i akuzuari, faqe 355-358;
- Procesverbal i shqyrtimit kryesor 23 mars 2013, faqe 259-365;
- Fjala përfundimtare e prokurorit, faqe 360-363;
- Fjala përfundimtare e palës së dëmtuar **Z.D.**, faqe 363;
- Procesverbal i shqyrtimit kryesor 26 mars 2013, faqe 366-372;
- Fjala përfundimtare e avokatit mbrojtës, faqe 367-369;
- Përgjigja e prokurorit, faqe 369-370;
- Përgjigja e avokatit mbrojtës, faqe 370-371.

V. PRANUESHMËRIA E PROVAVE

V.1. Deklaratat e dëshmitarit **Xh.S.**

19. Prokurori Publik i Qarkut ne Aktakuzën PP nr. 146/2010 të ngritur me 15 shkurt 2011, ka propozuar që të dëgjohet **Xh.S.** në cilësinë e dëshmitarit. Gjykata e ka ftuar **Xh.S.** për seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18 qershor 2013 por sipas informatave të marra prej Zyrës së Postës dëshmitari ka qenë jashtë vendit.
20. Më 17 qershor 2013 Gjykata e ka urdhëruar Policinë të bëjë hetime rreth vendndodhjes së këtij dëshmitari dhe kthimit eventual të tij në Kosovë.

21. Më 18 qershor dhe 9 korrik 2013, Gjykata është informuar nga Policia se dëshmitari **Xh.S.** jeton jashtë vendit. Babai i dëshmitarit nuk ka dhënë kurrfarë detaje të kontaktit dhe as nuk e ka informuar Policinë rreth vizitave të mundshme të djalit të tij në Kosovë.
22. Më 16 korrik 2013 prokuroria ka paraqitur propozime para Gjykatës për dëgjimin e dëshmitarit përmes skype sepse ky i fundit e ka dhënë pëlqimin të dëshmojë përmes mjeteve të tilla specifike. Ai nuk do të kishte dëshirë ta japë adresën e tij apo t'i ndihmojë Gjykatës në asnjë mënyrë tjetër. Në të njëjtën datë Gjykata e ka refuzuar kërkesën⁹.
23. Më 17 korrik 2013, Prokuroria e ka informuar Gjykatën me e-mail se ata nuk do të dorëzojnë kërkesën për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare (me poshtë NJN) në lidhje me këtë dëshmitar; dëshmitari e ka lajmëruar Task Force të Mitrovicës se ai nuk do t'u përmbahet vullnetarisht ftesave dhe ai nuk do ta zbulojë adresën e tij; prandaj, ai nuk mund të kontaktohet nga Gjykatat dhe policia jashtë vendit për qëllime të dhënies se dëshmisë përmes NJN. Ky qëndrim është ri-konfirmuar nga ana e Prokurorit gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 29 korrik 2013. Mirëpo, Prokuroria ka paraqitur propozimin që deklaratat e mëparshme të dëshmitarit të dhëna në fazën e hetimeve të lexohen në procesverbal sipas nenit 368 të KPPK-së.
24. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 29 korrik 2013 avokati mbrojtës Mahmut Halimi e ka kundërshtuar kërkesën e lartpërmendur të Prokurorit dhe ai e ka ngritur çështjen e pranueshmërisë së deklaratave të **Xh.S.** të dhëna Policisë dhe Prokurorit Publik. Baza për këtë sfidë ka qenë fakti se avokati mbrojtës nuk ka qenë i pranishëm gjatë intervistave. Avokati mbrojtës gjithashtu ka deklaruar se ai nuk ishte i informuar rreth datës së intervistave.

⁹ Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor 16 korrik 2013, faqe 15;

25. Dëshmitari **Xh.S.** ishte intervistuar nga Policia më 23 nëntor 2010 si dhe nga Prokurori Publik më 09 Shkurt 2011.
26. Trupi gjykues e ka adresuar çështjen e pranueshmërisë së provave të ngritura nga ana e avokatit mbrojtës.
27. Neni 153 paragrafi (1) i KPPK-së në mënyrë eksplicite thotë se provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.
28. Neni 156 paragrafi (2) i KPPK përcakton se deklarata e dëshmitarit e dhënë Policisë apo Prokurorit Publik mund të jetë provë e pranueshme në Gjykatë vetëm atëherë kur të pandehurit apo avokatit mbrojtës i është dhënë mundësia ta sfidojnë atë duke e marrë në pyetje atë dëshmitar gjatë ndonjë faze të procedurave penale.
29. Trupi Gjykues ka vërtetuar se ligji është shumë i qartë për këtë dhe se nuk ka vend për liri veprimi në zbatimin e nenit 156 paragrafi (2) të KPPK. Është vërtetuar duke u bazuar në dëshminë e dëshmitarit **Xh.S.** të dhënë Policisë dhe Prokurorit dhe se avokati mbrojtës nuk ka qenë i pranishëm gjatë intervistës dhe gjatë procedurës kurrë nuk e ka pasur mundësinë ta sfidojë dëshminë në fjalë.
30. Prandaj, në datën e lartë-përmendur, sipas nenit 153 paragrafi (1) të KPPK dhe nenit 156 paragrafi (2) të KPPK, trupi gjykues e ka shpallur dëshminë në vijim si të papranueshme.¹⁰: **Xh.S.** , Procesverbal i intervistës me dëshmitarin, i përpiluar më 23 nëntor 2010; **Xh.S.** , Procesverbal i intervistës me dëshmitarin, i përpiluar më 09 shkurt 2011.
31. Në kuadër të procedurave të tanishme të rigjyqimit, në seancën e datës 11 gusht 2014, prokuroria kishte kërkuar me gojë që të thirret dëshmitari **Xh.S.**

¹⁰Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor 29 korrik 2013, faqe 2;

32. Pas kërkesës së lartcekur nga prokuroria, gjykata ka bërë përpjekje për ta thirrur dëshmitarin **Xh.S.** Sipas prokurorisë, dëshmitari, i cili banon jashtë vendit, ishte dashur ta vizitonte Kosovën. Mirëpo, ai nuk ka mundur të kontaktohej dhe përpjekjet për të siguruar informata të mëtejme sa i përket vendndodhjes së tij kanë qenë të pasuksesshme.
33. Kërkesa e lartcekur nga prokuroria u pasua menjëherë me një kërkesë me shkrim ku i kërkohej Gjykatës që të paraqesë kërkesë me shkrim për ndihme juridike ndaj Finlandës, me synimin që ta marrë në pyetje dëshmitarin **Xh.S.** përmes skype-it ose video-lidhjes ose formave të tjera të komunikimit.
34. Trupi gjykues vlerësoi se elementet e bëra me dije nga prokuroria në mbështetje të propozimit të tyre janë të pamjaftueshme për ta gjetur vendndodhjen e dëshmitarit dhe kësaj t'u kërkojë ndihmë juridike autoriteteve në Finlandë. Konkretisht, neve na është dhënë vetëm informata se dëshmitari jeton në Finlandë, por madje edhe ky aspekt ishte i dyshimtë.
35. Për më tepër, Departamenti për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare në kuadër të EULEX-it është interesuar të pyes në të gjitha (katër) vendet skandinave - Norvegji, Finlandë, Danimarkë dhe Suedi. Të gjitha (katër) vendet kanë raportuar se nuk ka evidencë të regjistruar për vendndodhjen e dëshmitarit.
36. Në mungesë të informatave të mjaftueshme për ta gjetur vendndodhjen e dëshmitarit, kërkesa nga prokuroria për ndihmë ndërkombëtare ishte refuzuar¹¹.
37. Andaj, praktikisht ishte e pamundur për Gjykatën që ta dëgjojë këtë dëshmitar drejtpërdrejt.

¹¹ Për arsyetim të hollësishëm shih Aktvendimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës të datës 9 shtator 2014;

38. Pasi deklaratat e këtij dëshmitari gjatë procedurës paraprake – domethënë procesverbali i intervistës së dëshmitarit, i përpiluar më 23 nëntor 2010 dhe procesverbali i intervistës së dëshmitarit, i përpiluar më 09 shkurt 2011- trupi gjykues e ripërsërit qëndrimin e vet nga rigjykimet e mëparshme në lidhje me pranueshmërinë e tyre (shih pikën 31).

V.2. Raporti mjekësor nga Qendra Klinike Universitare e Prishtinës i datës 25.08.2014 (dhe i paraqitur më 26.08.2014)

39. Në seancën e datës 11.08.14, trupi gjykues e pranoi kërkesën e mbrojtjes për dëgjim të dy dëshmitarëve: Doktorin **F.B.**, i cili nënshkroi raportin e autopsisë të të ndjerit dhe një kardiolog. Si rrjedhojë, u lëshuar një urdhër ndaj Prof. Dr **B.Z.**, Drejtor i QKUK-së, Klinikës së Kardiologjisë, Prishtinë, për të cekur një numër prej tre kardiologëve nga të cilët trupi gjykues mund ta zgjidhte për të dëshmuar.
40. Në përgjigje, Prof. Dr **B.Z.** kishte një paraqitur një raport mjekësor të pa kërkuar të datës 26.08.2014 dhe të nënshkruar nga tre kardiologë të Qendrës Klinike Universitare të Prishtinës. Raporti iu dorëzua me kohë palëve.
41. Njëri nga mjekët të cilët e kishin nënshkruar raportin, Dr. **M.G.**, dëshmoi si dëshmitar më 16 tetor 2014.
42. Prokuroria, në fjalën e vet përfundimtare, e vuri në pikëpyetje pranueshmërinë e raportit dhe propozoi që ai të përjashtohet nga shkresat e lëndës¹². Sipas Prokurorisë, Gjykata e pranoi këtë raport në procedurë pa pyetur për opinionet ose kundërshtimet të asnjërës prej palëve. Sipas Prokurorisë, raporti nuk ka bazë ligjore pasi që ai ishte paraqitur pa një urdhër nga Gjykata.

¹² Shih fjala përfundimtare e prokurorisë, tab 2, Shtojca C, e datës 13 nëntor 2014;

43. Sipas nenit 154 paragrafi (2) të KPPK-së, "Çështja lidhur me pranimin e provës mund të ngritet nga pala në kohën kur prova i paraqitet gjykatës [...] Përjashtimisht, mund të ngritet më vonë, nëse çështjet nuk i janë bërë të njohura palës në kohën kur prova është paraqitur, ose ekzistojnë rrethana të tjera të justifikueshme". Si prokurorisë, ashtu edhe mbrojtjes u është dorëzuar raporti në shtator të vitit 2014 dhe si rrjedhojë kanë qenë në dijeni paraprakisht për përmbajtjen e tij. Të dyja palët kanë qenë plotësisht në dijeni të urdhrin fillestar të gjykatës¹³. Kufizimet e urdhrin të Gjykatës dhe raporti të cilën ne e kemi marrë si përgjigje po ashtu u janë prezantuar në detaje palëve në fillim të seancës së datës 16 tetor 2014¹⁴. Të dyja palët, duke përfshirë prokurorinë, bazuar në ekzaminimin e tyre të dëshmitarit ekspert Dr. **M.G.** në raportin e kontestuar. Prokuroria madje ka sjellë edhe material dokumentues shtesë dhe e ka përdorur atë për ta vlerësuar në mënyrë kritike raportin mjekësor¹⁵.
44. Andaj, ky kundërshtim i prokurorisë është refuzuar. Jo vetëm që është i paafatshëm, por nuk bie në asnjërin nga bazat për pranueshmëri që parashihen me ligj. Neni 153 paragrafi 1 i KPPP-së parasheh që "provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu". Madje edhe nëse raporti nuk ishte i porositur, si forma ashtu edhe përmbajtja e tij në asnjë mënyrë nuk janë në asnjë kundërshtim me dispozitat ligjore. Për më tepër, raporti ishte shfrytëzuar dhe si rrjedhojë ishte pranuar në mënyrë të nënkuptuar nga të dyja palët. Raporti paraqet prova të pranueshme.

¹³ Shih procesverbalin e vizitës në vendin e ngjarjes 13 gusht 2014, faqe 4, versioni anglisht ;

¹⁴ Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor 16 tetor 2014, faqe 2, versioni anglisht; ku Kryetari i trupit gjykues paraqet si vijon: "Unë po ashtu më duhet ta cek se ne kemi marrë një raport të pa kërkuar nga Spitali i Prishtinës, ndonëse ne kërkuam vetëm emrat e tre kardiologëve. Raporti po ashtu paraqet konkluzionet në lidhje me kapacitetin e palës së dëmtuar për të ndërmarrë veprim pasi ai kishte marrë goditje në zemër.";

¹⁵ Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor 16 tetor 2014, faqe 8, versioni anglisht;

VI. SHQYRTIMI KRYESOR

VI.1. Përmbledhje e Provave

45. Dëshmitë e administruara ne këtë ri-gjykim kane te bëjnë vetëm me akuzën e Vrasjes. Lista e plotë e dëshmimeve të prezantuara dhe të shpallura të pranueshme në këtë lëndë penale është e listuar në pjesën e IV-të të këtij aktgjykimi (me lart). Këto provë formojnë bazat për vendimin e trupit gjykues në këtë lëndë.
46. Trupi gjykues ka kërkuar dëshminë e një numri prej 21 dëshmitareve për te përcaktuar faktet e incidentit të datës 18 nëntor 2010 qe kane rezultuar ne vdekjen e **M.D.**. Dëshmitë e tyre mund te ndahen ne këto tri kategori:

-Personat e pranishëm afër apo ne vendin e ngjarjes para/gjatë / apo pas veprës penale: **A.K.**¹⁶, **A. H.** ¹⁷, **E. Sh.** ¹⁸, **S. M.** ¹⁹, **H. D.**²⁰; dëshmia e mëparshme e dëshmitarit **Xh.I.** ishte konsideruar si e lexuar në procesverbal me 19 qershor 2013²¹.

-Zyrtarët e Policisë pjesëmarrës në hetime dhe te pranishëm ne vendin e ngjarjes: **R.P.** ²², **S. S.** ²³, **H. B.** ²⁴, **Rr. M.** ²⁵, **G. K.** ²⁶, **F. Sh.** ²⁷.

-Dëshmitarët ekspert (ekspertet mjekësor dhe te mjekësisë ligjore): **Z.M.** ²⁸, **C.B.** ²⁹ dhe **M.G.**³⁰; dëshmia e mëparshme e dëshmitarit ekspert

¹⁶ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 16 korrik 2013, faqe 16;

¹⁷ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 20 qershor 2013, faqe 2;

¹⁸ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 19 qershor 2013, faqe 20;

¹⁹ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 19 qershor 2013, faqe 2;

²⁰ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 19 qershor 2013, faqe 27;

²¹ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 19 qershor 2013, faqe 32;

²² Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 18 qershor 2013, faqe 9;

²³ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 18 qershor 2013, faqe 20;

²⁴ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 19 qershor 2013, faqe 13;

²⁵ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 20 qershor 2013, faqe 16;

²⁶ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 20 qershor 2013, faqe 26;

²⁷ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 20 qershor 2013, faqe 20;

²⁸ Procesverbal i seancës se shqyrtimit kryesor 15 korrik 2013, faqe 2;

²⁹ Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor 15 korrik 2013, faqe 8;

M.G. gjithashtu është konsideruar si e lexuar ne procesverbal me 18 qershor 2013³¹; ndër të tjera edhe dëshmitarët ekspertë **F.B.** dhe **M. G.**³².

47. Trupi gjykues gjithashtu e ka dëgjuar dëshminë e Palës së dëmtuar **Z.D.** ³³, djalit të viktimës **M.D.**, i cili kryesisht ka dhënë dëshmi për historinë e marrëdhënies ndërmjet të akuzuarit dhe viktimës dhe rreth zakoneve dhe gjendjes fizike te palës së dëmtuar si dhe sjelljes së tij mu para vdekjes së tij.
48. Trupi gjykues gjithashtu e ka marrë në intervistë **A.D.**³⁴, djalin tjetër të viktimës, në mënyrë që të përcaktohet se a ka qenë dëshmitari **A.K** si dëshmitar okular në veprën penale të Vrasjes apo jo. Ai gjithashtu ka deklaruar rreth sjelljes së babait të tij para vdekjes së tij.
49. Zyrtarët e policisë kanë dhënë dëshmi për vazhdimet dhe veprimet e tyre kur kanë arritur në vendin e ngjarjes më 18 nëntor 2010, kanë bërë mbledhjen dhe mbajtjen e mëtutjeshme të dëshmive në këtë lëndë.
50. Dëshmitari ekspert **Z.M.** ka deklaruar rreth lëndimeve dhe gjendjes shëndetësore të të akuzuarit dhe Gjykata ka konsideruar deklaratën e dhënë nga dëshmitari ekspert **M.G.** gjatë gjykimit të parë që kanë lidhje me të njëjtat aspekte.
51. Dëshmitarët ekspert **C.B.** dhe **M. G.** kanë deklaruar rreth lëndimeve të marra nga **M.D.** dhe autopsinë e kryer mbi viktimën.
52. Në ditën kritike, dëshmitari **S.M.** ishte në një stacion autobusi afër vendngjarjes. Megjithatë, ai deklaroi se ai nuk e kishte parë se si kishte filluar e as se si

³⁰ Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor 16 korrik 2013, faqe 3;

³¹ Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor 18 qershor 2013, faqe 8;

³² Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor 16 tetor 2014, versioni anglisht ;

³³ Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor 17 qershor 2013, faqe 10;

³⁴ Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor të datës 18 qershor 2013, faqe 2;

kishte evoluar konfrontimi në mes të dy palëve. Ai ka mohuar ndonjë intervenim nga ana e tij për t'i ndarë ata. Ai vetëm e ka parë një motoçikletë të praptuar në rrugë afër vendngjarjes.

53. Dëshmitarët **H.D.** dhe **Xh. I.** kanë qenë punëtorët prezent në një lokacion ndërtimi afër vendngjarjes në ditën e ngjarjes (18 nëntor 2010) por asnjëri prej tyre nuk dha tregim si dëshmitar okular për përleshjen në mes të të akuzuarit dhe **M.D.**
54. Dëshmitarët **A.H., A.K., dhe E.Sh.** janë identifikuar si të pranishëm në ose afër vendngjarjes në ditën e ngjarjes, por asnjëri prej tyre nuk ka dëshmuar se si ka filluar konflikti në mes të të akuzuarit dhe **M.D.** Dëshmitarët kanë dëshmuar për rezultatin e grindjes dhe çfarë kanë parë kur ballafaqimi në mes të dy burrave tashmë ishte duke u zhvilluar ose kur përfundoi.
55. Dëshmitari **A.H.** është taksist i cili në ditën kritike kaloi afër vendngjarjes; me atë rast ai ishte i ulur në karrigen e pasagjerit përderisa taksinë e drejtonte shoku i tij, dëshmitari **Xh.S.** . Dy dëshmitarët janë ata që e transportuan palën e dëmtuar për në spital. **A.H.** e ka dhënë deklaratën e tij të parë në Polici më 23 nëntor 2010, pra pesë ditë pasi që ka ndodhur vepra penale. **A.H.** ka përshkruar se çfarë ka parë te ura, duke deklaruar që kur ai është afruar te vendngjarja me shokun e tij, ai i ka parë dy persona të përfshirë në një përleshje të cilët pastaj janë rrezuar dhe janë rrotulluar poshtë rrugës. Të dy personat e përfshirë në përleshje kishin thika në duar. Kur janë rrëzuar, njëri prej tyre mbeti i shtrirë dhe tjetri kishte fytyrën të përgjakur dhe qëndronte në këmbë me thikë në dorë të cilën pastaj ai e gjuajti në drejtim të Shipolit. Ai e ka parë personin i cili ka qenë më i rëndë përmbi atij tjetrit duke e goditur atë. I pranishëm ka qenë edhe një person i tretë i cili tentonte ta ndante personin e përgjakur. **A.H.** ka dhënë një deklaratë tjetër më 9 shkurt 2011 në Prokurori Publike ku ai në esencë ka ritheksuar deklaratën e tij të dhënë në polici. Gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor, **A.H.** është marrë në pyetje më 21

shkurt 2012. Dëshmitari fillimisht ka deklaruar që deklaratat e tij në Polici dhe Prokurori Publike kanë qenë të vërteta dhe ai gjithashtu ka njohur nënshkrimin e tij në të dy procesverbalet. Kur është marrë në pyetje në Gjykatë, dëshmitari megjithatë është tërhequr nga disa pjesë të deklaratave të tij të mëparshme, në veçanti sa i përket nëse ai i ka parë dy burrat duke u përleshur dhe nëse ata kanë pasur thika. Ai gjithashtu ka mohuar ta ketë incizuar ngjarjen me telefonin e tij mobil. Trupi gjykues ka ballafaquar dëshmitarin me këto mospërputhje por dëshmitari nuk ka dhënë kurrfarë përgjigje të kënaqshme se pse tregimi i tij për ngjarjen befasisht ndryshoi. Në vija të përgjithshme, dëshmitari qëndroi pranë pozitës së tij të fundit edhe gjatë rigjyimit. Ai pohoi që ai dhe **Xh.S.** kanë parë një motoçikletë poshtë rrugës afër vendngjarjes dhe ata e kanë ndaluar veturën, duke menduar që ndoshta kishte ndodhur një aksident trafiku. Kur janë ndaluar, ata kanë parë dy palë që ishin “aty poshtë”, 15-20 m larg. Pasi që ka deklaruar më parë që personi “më i rëndë” ishte mbi atë tjetrin, gjatë rigjyimit ai ka cekur të pandehurin si më të rëndin. Viktima ka qenë e shtrirë në shpinë dhe të pandehurit i rridhte gjak nga fytyra, dhe ai “mbahej nga dy njerëz dhe sillej përpara”. Dëshmitarit i kujtohet prezenca e 4-5 dëshmitarëve të tjerë në vendngjarje, njëri prej të cilëve mund të jetë **E.Sh.** Megjithatë, ai nuk mund të cekë me vendosmëri identitetin e ndonjërit prej këtyre personave. Ai pohoi që ai nuk e ka parë asnjë sekuencë të përleshjes. Ai gjithashtu mohoi të ketë incizuar ngjarjen me telefonin e tij mobil. Ngjashëm me shqyrtimin e parë gjyqësor, dëshmitari nuk mund të jepte shpjegim të besueshëm se pse ai e ka ndryshuar tregimin e tij të mëparshëm. Ai gjithashtu ka konfirmuar përsëri autenticitetin e nënshkrimit të tij në të gjitha deklaratat e mëparshme.

56. Trupi gjykues i konsideron deklaratat fillestare të dëshmitarit në Polici dhe në Prokurori Publike si dëshmi e vërtetë e asaj që në të vërtetë e ka parë dëshmitari për arsyet në vijim: dëshmitari është marrë në pyetje pak kohë pas ngjarjes kur memoria e tij mbi ngjarjen ende ishte e freskët dhe kishte më pak gjasa që ai të ishte ndikuar në lidhje me deklaratën e tij. Për më tepër, ai nuk ofron asnjë shpjegim të besueshëm se si këto detaje, të cilat ai më vonë pretendoi se janë të pavërteta, janë futur në deklaratat e tij të dhëna në fazën e hetuesisë.

57. Dëshmitari **A.K.** është pronar i një dyqani afër vendngjarjes. Ai nuk ka qenë dëshmitar i përlëshjes në mes të të akuzuarit dhe viktimës dhe vetëm ka dëgjuar nga të tjerët që kishte ndodhur një përlëshje në mes të dy burrave. Ai ka qenë dëshmitar që i akuzuari ka kaluar pranë dyqanit të tij, dhe gjithashtu e ka parë një çantë të kuqe në bagazhin e tij.
58. Dëshmitari **E.Sh.** gjithashtu është pronar i një dyqani në afërsi të vendngjarjes. Ai ka dëshmuar që i ka parë dy burra të vjetër duke u përlëshur, të dy fillimisht ishin të shtrirë dhe i pandehuri është ngritur në këmbë. Ai ka qenë njeriu që e ka thirrur policinë por ai nuk ka qëndruar më në vendngjarje, dhe është kthyer në dyqanin e tij.
59. Dëshmitarët ekspertë **F.B.** dhe **M. G.** kanë dëshmuar në lidhje me kapacitetin e palës së dëmtuar për të ndërmarrë veprim pasi që kishte marrë goditjen në zemër.
60. I pandehuri **R. H.** ka dëshmuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 29 korrik 2013³⁵. Ai ka deklaruar që në ditën kritike, përderisa ai e voziste motoçikletën e tij në drejtim të Mitrovicës ku do të hante mëngjes, atë e ka ndalur pala e dëmtuar i cili qëndronte te Ura e Gjakut. Ky i dyti e ka sulmuar pastaj të pandehurin me thikë; pastaj i pandehuri ka përdorur briskun e tij të xhepit dhe e ka goditur palën e dëmtuar për të mbrojtur vetën. Në kuadër të procedurave aktuale, i pandehuri deklaroi se ai qëndron prapa dëshmisë së tij të mëparshme.

VI.2. Analiza e provave në lidhje me akuzën për Vrasje (Neni 146 i KPK) (Akuza 1)

Faktet e vërtetuara

61. Trupi gjykues e konsideron të vërtetuar që më 18 nëntor 2010 rreth orës 10:45 në vendin e quajtur Ura e Gjakut në Mitrovicë, i akuzuari **R.H.** e ka sulmuar viktimën **M.D.** me një thikë dhe e ka therë me thikë tetë herë në pjesë të

³⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 29 korrik 2013, faqja 4;

ndryshme të trupit, duke i shkaktuar katër plagë therëse në gjoks, dy në trung, një në shpatullën e majtë dhe një në bark. Plagët në gjoks në zonën e zemrës kanë rezultuar në vdekjen e **M.D.** rrugës për në klinikën mjekësore. I akuzuari **R. H.** ka vuajtur lëndime të vogla në ngjarje, një lëndim presioni në zgavër të syrit me plagë prerëse në kapak të syrit, rajoni i jashtëm temporal, plagë prerëse në zonën e kokës në pjesën e prapme, plagë prerëse shpuese në zonën e toraksit në anën e majtë, lëndime të fytyrës në lëkurë, fytyrë dhe pjesë të gjëndrës.

62. Të lartcekurat janë në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësor dhe forenzik, dëshmitarëve ekspertë **Z.M.**³⁶, **C.B.**³⁷ dhe **M.G.**³⁸ dhe mbi raportet mjekësore³⁹ të përpiluara në lëndë, të gjitha të konsideruara shumë të besueshme dhe të sigurta.
63. Nuk ka asnjë dyshim që i akuzuari dhe pala e dëmtuar **M.D.** janë përfshirë në një përleshje më 18 nëntor 2010 rreth orës 10.45 te Ura e Gjakut në Mitrovicë. I akuzuari vet e pranon që gjatë kësaj përleshje ai e ka "goditur" të ndjerin me thikën e tij disa herë. Gjithashtu nuk kontestohet që **M.D.** ka vdekur si pasojë e lëndimeve të pësuar gjatë ngjarjes.
64. Autopsia e plotë e të ndjerit zbuloi tetë lëndime të identifikuar nga DMF⁴⁰ - Doktor Forenzik si plagë therëse, një plagë therëse në shpatullën e majtë, një në bark, dy në trung dhe katër në gjoks. Shkaku i vdekjes, siç e ka përcaktuar mjeku forenzik, ka qenë një plagë therëse në gjoksin e **M.D.**, duke dëmtuar zemrën e tij.
65. Prandaj është e pakontestueshme që ditën kritike i akuzuari i ka shkaktuar plagë therëse të ndjerit; plaga therëse në zemër ka rezultuar në vdekjen e **M.D.**; nuk ka qenë

³⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 15 korrik 2013, faqja 2;

³⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 15 korrik 2013, faqja 8;

³⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 16 korrik 2013, faqja 2;

³⁹ Dosja e Prokurorisë 1, faqet 207, 208, 211, 215, 236-244, 254, 274 dhe 275;

⁴⁰ Departamenti i Mjekësisë Ligjore;

e përfshirë asnjë palë e tretë që do të shkaktonte lëndimin e të akuzuarit dhe/ose viktimës.

66. Në bazë të të cekurave më lart, trupi gjykues vjen në përfundim se është vërtetuar që **M.D.** ka vdekur si rezultat i një plage therëse të cilën ia ka shkaktuar i akuzuari.
67. Aspekti që duhet vërtetuar në këtë rigjykim është dinamika e ngjarjes në mes të dy palëve. Sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Paneli duhet të vërteton në rigjykim *“specifikisht nëse ekziston qëllimi i të akuzuarit për të kryer veprën penale si në aktakuzë apo a jemi në fakt duke u marrë me një veprë penale ndryshe sepse është fakti i pakontestueshëm që i ndjeri gjithashtu e ka goditur të akuzuarin me thikë. Gjykata gjithashtu duhet të verifikojë se për çfarë arsye saktësisht e ka marrë viktima me veti thikën në ditën kritike”*. Gjykata e Apelit gjithashtu rithekson që *“ajo që mbetet e kontestueshme është fakti në lidhje me atë se kush e sulmoi kë i pari, a është sulmuar i pari i akuzuari apo i ndjeri dhe nëse i akuzuari ka vepruar nga mbrojtja e nevojshme siç është pretenduar nga mbrojtja në ankesë, asnjë prej të cilave nuk i ka konfirmuar saktësisht gjykata e shkallës së parë.”*
68. Duke marrë parasysh të cekurat më lart dhe gjithashtu linjën e mbrojtjes, çështja kryesore përpara Trupit Gjykues është nëse i akuzuari, kur e ka shkaktuar lëndimin që rezultojë në vdekjen e **M.D.**, kishte vepruar në mbrojtje të nevojshme (vetëmbrojtje) siç pretendon ai.
69. Me fjalë tjera, a mund të vërtetohet që viktima **M.D.** ishte ai që papritmas sulmoi/provokoi të akuzuarin dhe nëse ky i dyti e ka nxjerrë dhe e ka goditur me thikë **M.D.** nga frika për jetën e tij? Nëse përgjigja është pohuese, veprimi i të akuzuarit nuk do të përbënte veprë penale.

70. Sipas nenit 8, të KPK-së, një vepër e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk përbën vepër penale. Një vepër e kryer në mbrojtje të nevojshme definohet si *"Kur personi e kryen një vepër për të zbrapsur një sulm të paligjshëm, real dhe të pashmangshëm ndaj vetes së tij/apo të saj apo të një personi tjetër dhe natyra e veprimit është në nivel proporcional të rrezikut që vjen nga sulmi"*.

71. Në vlerësimin e aspektit të vetëmbrojtjes, trupi gjykues vë re konsideratat si në vijim që rrjedhin nga doktrina dhe jurisprudenca:

72. Kur pretendohet vetëmbrojtja, pala e interesuar duhet ta provojë atë në mënyrë të mjaftueshme. Pretendimi i vetëmbrojtjes duhet të jetë më shumë se thjeshtë një pretendim i mbrojtjes. Duhet të jetë i bazuar mbi elementet që e bëjnë të mundshme vetëmbrojtjen e pretenduar, të besueshme, të mundur dhe që me gjasë ka ndodhur. Nëse Prokuroria nuk paraqet prova të mjaftueshme për të përjashtuar vetëmbrojtjen, atëherë standardi i vërtetimit përtej dyshimit të arsyeshëm të kundërligjshmërisë të veprimit të të pandehurit nuk mund të arrihet. Prandaj, në një rast të tillë, duhet të lëshohet një aktgjykim lirues. Për të dënuar një të pandehur, kërkohet përjashtimi i sigurt që ai ka vepruar në vetëmbrojtje. Dyshimi për vetëmbrojtjen sjell dyshime mbi kundërligjshmërinë e veprimeve të të pandehurit dhe prandaj në vet natyrën kriminale. Dhe kjo është saktësisht kur principi *"in dubio pro reo"* hyn në lojë. Nëse dyshimi mbi kundërligjshmërinë e veprimeve të të pandehurit ende ekziston madje edhe pas vlerësimit të materialit të përgjithshëm provues, atëherë kjo duhet të veproj në favor të të pandehurit dhe të nxitë lirimin e tij. Me fjalë tjera, një aktgjykim dënues mund të lëshohet vetëm nëse teza e vetëmbrojtjes është zbrapsur në tërësi.

73. Këto janë aspektet kryesore që Gjykata është dashtë të i vërtetojë në bazë të provave të përgjithshme. Gjetjet e Gjykatës janë si në vijim:

74. I dëgjuar nga Gjykata⁴¹ i akuzuari **R.H.** ka deklaruar që nuk i kujtohet saktësisht se çfarë ka deklaruar më parë, por ai e njuh nënshkrimin e tij në deklaratën e dhënë te Prokurori Publik më 10 janar 2011⁴². Ai tani e ka dhënë tregimin si në vijim mbi ngjarjen:

75. Në ditën kritike ai është larguar nga shtëpia e tij me motoçikletë. Ai e drejtonte ngadalë motoçikletën, kishte helmetë në kokë dhe shkonte në drejtim të Mitrovicës me qëllim të që hante mëngjes. Afër Urës së "Gjakut", në Mitrovicë, ai e ka vërejtur **M.D.** duke qëndruar në anën e majtë të rrugës me të dy duart në xhepa. I dyti e nxjerri dorën e majtë dhe ia bëri me dorë të akuzuarit që të ndalet. I akuzuari, sipas deklaratës së tij, ngadalësoi dhe filloi ta mbështes motoçikletën në mbështetësen e saj. Përderisa ai tentonte ta bënte këtë, **M.D.** iu afrua atij dhe menjëherë e kapi të akuzuarin për fyti. **M.D.** e tërhoqi të akuzuarin në drejtim të tij dhe e tërhoqi në anën e kundërt të rrugës (anën e majtë kur shkoni në drejtim të Mitrovicës). I akuzuari e ka vërejtur që viktima e mbante një thikë. **M.D.** e goditi të akuzuarin me dorëzën e thikës së pari në syrin e majtë, pastaj, kësaj here duke e përdorur tehun, në gjoks afër zemrës së tij dhe në kokë ku thika penetroi helmetën e të akuzuarit. Në këtë moment i akuzuari nxjerri thikën e tij me sustë nga xhepi, e hapi atë dhe filloi ta godas të ndjerin. Ai ia shkaktoi të gjitha goditjet viktimës pasi që ky i dyti kishte përfunduar sulmin e tij⁴³. Atij nuk i kujtohej saktësisht se ku dhe sa herë e ka goditur **M.D.**. Ai ka qenë duke tentuar të vetëmbrohet duke e përdorur thikën me sustë. Gjatë kësaj përleshjeje **M.D.** e ka shtyrë atë, i akuzuari "nuk mundi ta mbante më"; ata të dy u rrotulluan teposhtë nga rruga kryesore; i akuzuari "është rrotulluar përreth" dhe në fund i ka rënë të fikët. Ai nuk mundi të specifikonte sa gjatë ka qenë pa vetëdije por kur ka ardhur në vete ai e ka vërejtur që pamja e tij ishte e penguar nga gjakderdhja; ai ka dashtë të niset në drejtim të rrugës së Zhabarit, kur e ka dëgjuar zërin e një polici. Ai pastaj është çuar në një spital ku i është dhënë ndihma e shpejtë. I akuzuari e ka përdorur thikën me sustë,

⁴¹ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqja 4 dhe më tej;

⁴² Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqet 13 dhe 14;

⁴³ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqja 36;

tehu i të cilës ka qenë rreth 5-6 cm dhe e cila hapej duke e prekur një sustë⁴⁴. Ai nuk e ka lajmëruar policinë apo autoritetet tjera që atë e kishte sulmuar pala e dëmtuar⁴⁵. I akuzuari nuk dinte ndonjë arsye pse pala e dëmtuar e ka sulmuar atë; në fakt, ai kurrë nuk do të mund të imagjinonte që një ngjarje e tillë do të mund të ndodhte në mes tyre, pasi që ai ka besuar që ata i kishin zgjidhur të gjitha çështjet e mëparshme në mes tyre⁴⁶.

76. Trupi gjykues ka ndërmarrë përpjekje të shumta që të identifikojë dhe të i dëgjojë të gjithë dëshmitarët e mundshëm të drejtpërdrejtë që mund të japin dëshmi relevante në lidhje me përleshjen. Gjatë rigjykitimit, Trupi Gjykues ka dëgjuar dëshminë e gjashtëmbëdhjetë dëshmitarëve me qëllim që të përcaktojë nëse tregimi i ngjarjes siç e ka treguar i akuzuari është i saktë. Deklaratat e tre dëshmitarëve të tjerë janë konsideruar të lexuara për procesverbal. Megjithatë, asnjë dëshmitarë i identifikuar në vendngjarje gjatë ngjarjes nuk ka dëshmuar për vetë përleshjen në mes të dy burrave dhe si ka filluar dhe se si evoluar; kjo përkundër faktit që ngjarja ka ndodhur në një rrugë publike në një zonë të banuar relativisht dendur dhe në mes të ditës.

77. Është vërtetuar që më 18 nëntor 2010, rreth orës 10:00-10:30, i akuzuari është larguar nga shtëpia e tij në drejtim të Mitrovicës. Ai ka qenë duke drejtuar motoçikletën e tij kur ai i është afruar Urës së "Gjakut" ku ai e ka parë palën e dëmtuar duke qëndruar në anën e majtë të rrugës. Nuk mund të vërtetohet që ndonjëra prej palëve e ka ndjekur tjetrën; ne nuk mund të përfundojmë që pala e dëmtuar ka qëndruar pranë rrugës me qëllim që të i del në rrugë të pandehurit; **Z.D.** dhe **A.D.** kanë dëshmuar që në datën kritike babai i tyre është larguar nga shtëpia dhe është nisur për në bankë që të i depozitojë ca të holla. Viktima nuk e ka ditur se ku do të jetë i akuzuari atë ditë dhe nuk kishte asnjë qëllim që të takohet me të dhe, si sugjeron i akuzuari, ta sulmojë atë.

⁴⁴ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqja 18;

⁴⁵ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqet 20 dhe 21;

⁴⁶ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqet 31 dhe 32;

78. Është e vërtetë që në ditën kritike pala e dëmtuar e kishte një thikë me vete; kjo është në kundërshtim me dëshminë e ty dy djemve të tij që babai i tyre kurrë nuk ka bartur me vete thikë. Megjithatë, fakti që atë ditë viktimi e kishte një thikë nuk tregon domosdo për qëllimin e tij për ta sulmuar të pandehurin. Ai mund ta ketë bartur atë për mbrojtje pasi që ai e kishte me vete një shumë të madhe parash (2696,40 euro⁴⁷). Megjithatë, është tërësisht e palogjikshme që nga të gjitha rastet e mundshme, viktimi do të vendoste që të i afrohet të pandehurit saktësisht në rastin kur e çonte në bankë një sasi të konsiderueshme të parave. Vet fakti që pala e dëmtuar do të dinte për shprehitë e të pandehurit nuk mund të çon në përfundim që viktimi e ka ndjekur këtë të dytin. Palët kanë qenë fqinjë dhe në ato rrethana nuk është e pazakonshme që ata të jenë në dijeni për shprehitë e njëri tjetrit dhe zakonet personale të ditëpërditshme. Për më tepër, pasi që shtëpitë e palëve gjenden pranë njëra tjetrës, do të ishte shumë më lehtë për palën e dëmtuar që të ballafaqojë të pandehurin pranë shtëpisë së tij, në një zonë të cilën e njihnte më mirë, më të largët dhe më pak të ekspozuar ndaj publikut. Argumenti i njëjtë vlen edhe për të pandehurin. Trupi Gjykues vë re dëshminë e **Z. D.** që viktimi frikohej nga i akuzuari dhe para ngjarjes i është shmangur atij në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë, në mungesë të ndonjë prove tjetër për të mbështetur këtë, është vetëm spekulim të përfundohet që atë ditë specifike i pandehuri do të kishte hipur në motoçikletën e tij dhe ishte nisur me qëllim që të përcjellë palën e dëmtuar. Ka gjasa të barabarta që i pandehuri e ka bartur me vete thikën me sustë për qëllime të përdorimit personal.

79. Prandaj është vërtetuar që në ditën kritike palët kanë hasur rastësisht në njëri tjetrin te “Ura e Gjakut”. Saktësisht për shkak të natyrës së papritur të takimit, i pandehuri, kur vërejti palën e dëmtuar duke qëndruar pranë rrugës, e ndali motoçikletën dhe e mori një gurë të cilin pastaj e vendosi në shportën e motoçikletës brenda një çantë të kuqe pëlhere. Për të vërtetuar këtë aspektin e fundit, Trupi Gjykues konsideroi faktin që guri dhe çanta e kuqe janë gjetur në vendngjarje⁴⁸ dhe dëshminë e **A. K.** të dhënë

⁴⁷ Dosja e Prokurorit faqja 183;

⁴⁸ Dosja e Prokurorit faqja 284;

në Polici dhe në Prokurori⁴⁹. Sipas deklaratave të tij, dëshmitari ka vërejtur të pandehurin duke e bartur një çantë të kuqe në duar: ai gjithashtu ka dëgjuar nga të tjerët që i pandehuri, para se të i afrohet viktimës, e ka marrë një gurë dhe e ka vendosur në çantën e kuqe. Siç u paraqit më parë, kjo dëshmi para-gjyqësore konsiderohet më i besueshme në krahasim me tregimin që dëshmitari e ka dhënë para Gjykatës.

80. Për më tepër, shpjegimi i të pandehurit në lidhje me çantën e kuqe dhe përmbajtjen e saj nuk mund të pranohet. Ai pretendon që "shumë herë fëmijët kanë futur gjëra të ndryshme brenda", sikurse pemë, apo degë të pemëve⁵⁰. I akuzuari ka vërejtur që çanta e kuqe ishte në shportën e motoçikletës kur ai është nisur nga shtëpia; megjithatë ai nuk e ka kontrolluar përmbajtjen e saj. Gjykata e ka të vështirë të besojë këtë shpjegim, dhe gjithashtu edhe pretendimin e të pandehurit që ai gjithmonë e ka lënë çantën e kuqe në shportë, në të hapur dhe në muaj të dimrit (nëntor).

81. Pasi që ka vërtetuar që i pandehuri ka marrë një gurë menjëherë para se të i afrohej palës së dëmtuar, Trupi Gjykues atëherë përjashton shpjegimin e të akuzuarit se pse ai është ndalur. Më saktësisht, ai ka deklaruar që e ka ndalur motoçikletën pasi që pala e dëmtuar ia ka bërë atij me dorë; pretendohet që kjo e ka shtyrë të pandehurin të besoj që pala e dëmtuar ka dashtë ta përshëndet atë, pasi që ka qenë dita e 3-të e Bajramit⁵¹. Ky shpjegim - që i pandehuri ka pritur një takim shoqëror - është në kundërshtim me faktin që i pandehuri në fakt e ka marrë gurin menjëherë para takimit me palën e dëmtuar. Kjo gjithashtu nuk përputhet me atë që i pandehuri vetë e ka deklaruar që në rastet e mëparshme pala e dëmtuar nuk ka folur me të e as nuk e ka përshëndetur, as kur ata kanë qenë përballë në kombin e njëjtë; i pandehuri bile e ka ballafaquar palën e dëmtuar lidhur me këtë⁵².

⁴⁹ Dosja e Prokurorit faqet 141 dhe 153;

⁵⁰ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqet 14 dhe 15;

⁵¹ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqja 5;

⁵² Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqja 25;

82. Nuk është asnjë dëshmitar që mund të na tregojë se çfarë ka ndodhur kur janë takuar dy palët, si ka filluar dhe si është zhvilluar konflikti i tyre. Dëshmitë e dëshmitarëve **A. H.** dhe **E. Sh.** janë dëshmitë e vetme që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me dinamikën e përleshjes. Ato mund të jenë relevante për vërtetimin e aspekteve në lidhje me për shembull tejkalimin e vetëmbrojtjes nga njëra prej palëve. Por, për të u tejkaluar vetëmbrojtja, ne duhet të fillojmë duke vërtetuar se kush ka vepruar në vetëmbrojtje në rend të parë. Prandaj, Trupi Gjykes do të vlerësoj së pari dëshmitë në lidhje me atë se si ka filluar ngjarja dhe cila prej palëve ka vepruar në vetëmbrojtje. Këto dëshmi përbëhen prej deklaratave të dëshmitarëve, raporteve mjekësore të të pandehurit⁵³, raporti i autopsisë së palës së dëmtuar⁵⁴, dhe dëshmitë e dëshmitarëve ekspert **Z. M.**⁵⁵, **C. B.**⁵⁶ dhe **M. G.**⁵⁷.

83. Siç është paraqitur më lart, përjashtohet që i akuzuari ka besuar që pala e dëmtuar ka tentuar të ketë bisedë shoqërore. Prandaj, ne i kemi vërtetuar dy mundësi:

- a. I akuzuari ka pritur që pala e dëmtuar do të jetë agresive ndaj tij, ose
- b. I akuzuari i është afruar palës së dëmtuar me qëllime agresive.

84. Për të vepruar në vetëmbrojtje, është kyçe që goditja me thikë të jetë përndryshe e pashmangshme. Vrasja e dikujt duhet të jetë zgjidhja e fundit, kur të gjitha alternativat tjera kanë dështuar. Nëse njeriu mund të ikë, atëherë duhet ta bëjë këtë. Në rastin tonë, i pandehuri ka qenë duke ngarë motoçikletën e tij dhe pala e dëmtuar ka qenë duke qëndruar në anën e kundërt të rrugës. I akuzuari ka mundur të vazhdoj rrugën, të ikë dhe të shmang çdo konfrontim me palën e dëmtuar.

⁵³ Dosja e Prokurorit, faqja 254;

⁵⁴ Dosja e Prokurorit, faqe 236;

⁵⁵ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 15 korrik 2013, faqja 2 e më tej;

⁵⁶ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 16 korrik 2013, faqja 3 e më tej;

⁵⁷ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 16 korrik 2013, faqja 3 e më tej;

85. Jo vetëm që i akuzuari nuk ka zgjedhur që të shmangë ballafaqimin, por ai bile ka marrë një qëndrim më aktiv ndaj tij. Ai nuk e ka ndalur thjeshtë motoçikletën dhe të ngritët në të përderisa ka pritur që pala e dëmtuar të i afrohet atij. Në vend të kësaj, ai ka zgjedhur që të mbështet motoçikletën në mbështetësen e saj⁵⁸. Shpjegimi i të akuzuarit është që ka vepruar kështu nga respekti, sepse nuk është mirësjellje që të flasësh me dikë përderisa qëndron në motoçikletë. Ky shpjegim thjeshtë nuk konsiderohet i besueshëm. Në një situatë konflikti, sjelljet shoqërore do të ishin brenga e fundit për çdo person të arsyeshëm. Në realitet, kjo vërteton që i akuzuari ka marr rol aktiv në konflikt dhe që ai në fakt i është afruar palës së dëmtuar. Në mbështetje të këtij përfundimi është edhe fakti që incidenti ka ndodhur përderisa palët kanë qenë në anën e majtë të rrugës (drejtimi Skenderaj-Mitrovicë). Kjo gjendet në anën ku pala e dëmtuar ka qëndruar fillimisht dhe në anën e kundërt të shtegut ku i pandehuri e ka ndalur motoçikletën e tij⁵⁹. Sipas deklaratës së të pandehurit⁶⁰ pala e dëmtuar e ka kaluar rrugën ku ka qenë i akuzuari, e ka kapur atë dhe e ka tërhequr në anën tjetër; vetëm pasi që kanë arritur në anën e majtë të rrugës pala e dëmtuar ka filluar ta sulmoj të pandehurin. Këtij shpjegimi konsiderohet se i mungon logjika. Pse do të zgjedhtë dikush që të humbas momentin dhe elementin e befasisë së një sulmi duke e sjell objektivin nga njëra anë në anën tjetër të rrugës? Trupi gjykues është i mendimit që lokacioni i konfliktit (ana e majtë e rrugës) tregon për faktin që në të vërtetë i pandehuri e ka ndjekur palën e dëmtuar. Kjo sipas mendimit të Trupit Gjykues mbështet përfundimin që nuk është sulmuar i akuzuari befasisht nga viktima por ka qenë saktësisht e kundërta.

86. Ka aspekte tjera që mbështesin gjetjen e njëjtë. I akuzuari në vendngjarje është parë i mbuluar me gjak dhe ka vuajtur edhe vet disa lëndime. Doktor **Z. M.** ka dëshmuar për lëndimet e të akuzuarit dhe ka thënë që ai ka vuajtur një lëndim presioni në zgavër të syrit me plagë prerëse të kapakut të syrit, të rajonit të jashtëm temporal, lëndime në

⁵⁸ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqet 37 dhe 38;

⁵⁹ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqja 37;

⁶⁰ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqet 35 dhe 37;

lëkurë të fytyrës, fytyrë dhe pjesë të gjëndrës⁶¹. E njëjta gjithashtu është regjistruar në dëshmitë e dokumentuara, pra në fletë lëshimin e të akuzuarit, të datës 22.11.2010⁶². Në deklaratën e tij, i akuzuari gjithashtu konfirmon që goditja që e ka vuajtur në sy është shkaktuar me dorëz të thikës e jo me teh. Ai shpjegon që pala e dëmtuar e ka bërë goditjen e parë me teh të thikës në zgavër të syrit të të akuzuarit; pastaj pala e dëmtuar e ka kthyer thikën dhe duke e përdorur tehun e ka goditur të akuzuarin në gjoks dhe pastaj në zonë të kokës, më saktësisht në helmetë. Sipas tregimit të tij, i pandehuri së pari i ka vuajtur të gjitha goditjet nga pala e dëmtuar; vetëm pastaj ai e ka marrë thikën sustë nga xhepi i tij, e ka hapur atë dhe pastaj ai ka filluar ta godas palën e dëmtuar⁶³.

87. Ka shumë pak gjasa që pala e dëmtuar, po të kishte filluar ai sulmin, do të zgjidhte të përdorte pjesën më pak dëmtuese të thikës - dorëzën e saj. Është gjithashtu mjaft e pazakonshme dhe jo e natyrshme si pozitë për të mbajtur thikën kur e sulmon dikë. Njëjtë jo e natyrshme do të ishte lëvizja me të cilën pala e dëmtuar e ka kthyer thikën në dorën e tij të djathtë përderisa ishte në proces të kryerjes së një sulmi.
88. Po të kishte pasur viktimë me të vërtetë për qëllim që ta godas dhe dëmtoj të akuzuarin, gjithashtu mbetet e pashpjeguar se pse ai nuk do ta sulmonte së pari në zonë të zemrës, e cila ishte e pambrojtur; apo të priste që i akuzuari ta heq helmetën e tij dhe të jetë më i ekspozuar. Ka pak logjikë që një person që planifikon një sulm të godas personin tjetër në helmetë, kur ka mundur thjeshtë të pret disa sekonda që ai ta heq helmetën. Në të vërtetë, përsëri, është shpjegim shumë më logjik që sulmin e ka planifikuar i akuzuari i cili e ka lënë helmetën në kokë për mbrojtje.
89. Plagët therëse në fytyrë, gjoks dhe helmetë të të akuzuarit mbështesin që viktimë ka vepruar në vetëmbrojtje. Kjo gjithashtu shpjegon pse pala e dëmtuar fillimisht e ka

⁶¹ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 15 korrik 2013, faqja 4;

⁶² Dosja e Prokurorit faqja 254;

⁶³ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqet 36 dhe 37;

goditur të akuzuarin me dorëz. Viktima është kapur në befasi, e ka nxjerrë thikën nga xhepi i tij por nuk ka pasur mjaft kohë që ta drejtojë thikën në drejtim të akuzuarit.

90. Trupi gjykues gjithashtu nuk mund të pranojë tregimin e të pandehurit që ai vetëm është kundërpërgjigjur. Trupi gjykues nuk beson që i pandehuri, në qetësi të plotë, e ka nxjerrë thikën nga xhepi i tij, e ka liruar tehun dhe i ka shkaktuar tetë plagë therëse te viktima, njëra prej të cilave ishte fatale. Ai pretendon ta ketë bërë këtë pasi që ka vuajtur një lëndim të zgavrës së syrit që përkohësisht e ka penguar pamjen e tij dhe ia ka mbuluar fytyrën me gjak dhe që pastaj i ka rënë të fikët pasi që i ka kryer veprimet si më lart. Kjo përkundër faktit që viktima ka “qëndruar në terren më të lart” dhe ka qenë më i ri, më i gjatë dhe më i zhvilluar fizikisht se i akuzuari⁶⁴. Dhe e tërë kjo përkundër shëndetit të rënduar të pandehurit, i cili e ka përdorur mjetin për frymëmarrje me oksigjen dhe kishte marrë barna menjëherë para se të del nga shtëpia⁶⁵. Kjo thjeshtë nuk është e besueshme.
91. Trupi gjykues vënë re që duke krahasuar lëndimet e vuajtura nga i akuzuari dhe ato të viktimës, ky i dyti ka vuajtur lëndime shumë më serioze dhe më të qëndrueshme se i akuzuari. Trupi gjykues në veçanti i referohet faktit që shumica e plagëve therëse që i janë shkaktuar viktimës kanë qenë një zonën e gjoksit (katër).
92. Kjo sipas mendimit të trupit gjykues e mbështet përfundimin e njëjtë që i akuzuari ka qenë sulmuesi. Nëse përleshjen do ta kishte filluar viktima, siç deklaroi i akuzuari, i akuzuari do të ishte ai që ka vuajtur lëndime serioze. Por, ka qenë viktima ai që ka vuajtur lëndime shumë serioze dhe në fakt ka qenë i goditur në mënyrë të qëndrueshme në gjoks nga i akuzuari. Viktima i ka shkaktuar të akuzuarit lëndime të vogla, sipërfaqësore, që në fakt kanë qenë kryesisht prerje më të vogla dhe sidoqoftë lëndime të një natyre më të butë. Këto lëndime sipas mendimit të Trupit Gjykues janë

⁶⁴ Deklarata e të pandehurit, Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqja 18 dhe deklarata e Z. D., procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 17 Qershor 2013, faqet 17 dhe 18;

⁶⁵ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 29 korrik 2013, faqet 5 dhe 29;

tregues i faktit që viktima është zënë në befasi (pra është sulmuar) dhe është ai që ka qenë duke e mbrojtur vetveten. Viktima nuk e ka pritur sulmin dhe ka qenë duke e mbrojtur veten.

93. Ka qenë saktësisht natyra e papritur e sulmit që i ka dhënë të pandehurit përparësi mbi një individ më të ri, më të fortë dhe më të aftë. I pandehuri ka mbajtur përparësinë e tij gjatë përleshjesh dhe ka mbetur në pozitë dominuese edhe pasi që viktima ka rënë në tokë. Deklarata e dëshmitarit **A.H.** dhënë në polici vetëm 5 ditë pas ngjarjes është tregim i besueshëm i asaj që ai e ka parë. Ai ka vërejtur që “personi që ka qenë më i rëndë ka qenë përmbi të duke e goditur atë”. Përpara Gjykatës, ai ka treguar se i pandehuri ka qenë personi më i rëndë prej atyre dyve⁶⁶.
94. Gjetjet sikurse më lart, në të vërtetë bazohen në dëshmitë tani më të administruara nga Trupi gjykues, në shqyrtimin paraprak kryesor dhe ato konsiderohen ende të vlefshme.
95. Më poshtë, ne do të përqendrohemi në udhëzimet e Gjykatës së Apelit për rigjykim dhe në dëshmitë e reja të mbledhura në pajtim me ato udhëzime.
96. Në Aktvendimin e saj më 14 mars 2014, (rasti PAKR. No. 544/2013), Gjykata e Apelit urdhëroi që gjatë rigjykimit, Shkalla e parë duhet që të urdhërojë “një super ekspertizë të përbërë nga ekspertë të kombinuar të Mjekësisë Ligjore dhe gjithashtu edhe nga Kardiologjia, me qëllim që të dëshmohet lidhur me pretendimet e avokatit mbrojtës të të pandehurit, lidhur me të ndjerin, aftësinë e **M.D.** që të ndër marr ndonjë veprim pasi që ai kishte pësuar dëmtimin e zemrës dhe kjo konsiderohet si fakt shumë vendimtar nga ky Trupi gjykues gjithashtu, që të vërtetojë nëse viktima ishte sulmuar nga i akuzuari”.

⁶⁶ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 20 qershor 2013, faqja 13;

97. Në të njëjtin Aktvendim, Gjykata e Apelit gjithashtu ka vlerësuar se Trupi gjykues i rigjykimit “tërësisht ka dështuar që të justifikojë propozimin e Gjykatës së Apelit, rreth mundësisë e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, dhe gjithashtu ky Trup gjykues konsideron se kjo është diçka shumë thelbësore me qëllim të krijimit të vendit të ngjarjes, pozicionin e të pandehurit dhe të të ndjerit, drejtimi lëvizës i të akuzuarit me motoçikletë, dhe gjithashtu vendin e të ndjerit kur konflikti kishte ndodhur, fundi i ngatërresës në mes tyre, që pretendohet të ketë qenë poshtë shpatit të rrugës, pozita e dëshmitarit, e gjithashtu edhe faktet eventuale që do të mund të jenë të rëndësishme me qëllim që situata faktike të përcaktohet në mënyrë të drejtë dhe të tërësishme”.
98. Gjatë procedurave aktuale, Trupi ri gjykues me kujdes ka shikuar udhëzimet e Gjykatës së Apelit sikurse të paraqitura më lart.
99. KPK nuk rregullon “super ekspertizën e përbërë nga ekspertë të kombinuar” si formë e ndarë e mbledhjes së dëshmimeve. Trupi gjykues ka dëgjuar dëshmitarët ekspertë, **F. B.** dhe **M.G.**⁶⁷, lidhur me kapacitetin e palës së dëmtuar që të veprojë pasi që ai kishte marr goditjen në zemrën e tij.⁶⁸ Dëshmitari ekspert, **M. G.** ka miratuar gjetjet e Raportit mjekësor, të datës 25.08.2014 dhe ka nënshkruar me tre kardiologët brenda Qendrës Klinike Universitare të Prishtinës. Bazuar në raportin, “pas një plagosjeje të tillë të përshkruar në autopsi si lëndimi Nr. 1, pala e dëmtuar nuk ka pasur aftësi mbrojtjeje, të veprimit apo të reagimit. Pra, ai nuk kishte forcë të veprimit pas një lëndimi të tillë. Vdekja natyrisht është shoqëruar me kardilogjenik dhe hemorragjike të shpejtë”. Sido që të jetë, dëshmitarët ekspertë pajtohen me vërejtjet shkencore me doracakun e patologjisë e paraqitur nga Prokuroria.⁶⁹ Ai e pranon se lëndimet në anën e majtë të zemrës, në krahasim me ato të anës së djathtë, nuk përjashtojnë tërësisht kapacitetin e caktuar të reagimit të palës së dëmtuar pas goditjes.

⁶⁷ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 16 tetor 2014;

⁶⁸ Plaga e përshkruar në Raportin e Autopsisë si lëndim Nr. 1;

⁶⁹ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 16 tetor 2014, faqe 8, versioni në gjuhën angleze;

100. Duke dëshmuar në aspektin e njëjtë, dëshmitari ekspert, **F. B.** ka deklaruar se nuk ka të ngjarë se pala e dëmtuar, pas marrjes së goditjes në zemrën e tij kishte shkaktuar ndonjë lëndim tjetër mbi të pandehurin.⁷⁰

101. Ai “mbi të gjitha” pajtohet me të dhënat e raportit mjekësor të datës 25.08.2014 dhe e nënshkruar nga tre kardiologë të Qendrës Klinike Universitare të Prishtinës.⁷¹ Dëshmitari ekspertë paraqet se nuk ka të ngjarë që pala e dëmtuar ishte e aftë që të reagojë pas goditjes.⁷²

102. Me vlerësimin e dy dëshmimeve, Trupi gjykues konsideron sikurse më poshtë:

- Dy ekspertët pranojnë se përfundimet e tyre nuk mund të verifikohen me siguri të plotë.
- Madje edhe nëse e pranojnë se të gjitha goditjet mbi të pandehurin ishin trajtuar nga pala e dëmtuar para se ai (i fundit) mori goditjen në zemër, kjo nuk do të shpije tek një vlerësim tjetër të çështjes së vetëmbrojtjes.
- Vetëmbrojtja në thelb ka të bëjë me fillimin e konfliktit: kush ka sulmuar i pari?! Kur një pjesëmarrës e fiton cilësinë e sulmuesit dhe tjetri të mbrojtësit, statusi i tyre mbetet i pandryshuar përgjatë konfliktit. Fakti se sulmuesi nuk ka filluar duke shkaktuar lëndime vdekjeprurëse nuk i përket thelbit të problemit. Në fakt, sulmi madje, as nuk duhet të përbëhet nga një goditje. Një sulm i paligjshëm dhe i pashmangshëm gjithashtu mund të merr formën e kërcënimit e shoqëruar me vringëllimën e armës, apo mund të marr formën e “goditjes së humbur”. Si konflikti kishte përfunduar kështu, është jo e rëndësishme. Fakti se sulmuesi - në mes të veprimit me anën e të cilit ai filloi sulmin dhe në momentin kur ai tërhoqi goditjen vdekjeprurëse mbi viktimën - ishte ai vetë i goditur disa herë nga viktimja, nuk e ka vënë atë në pozitën e vetëmbrojtjes. Ai ende ishte ai i cili e fillojë sulmin e paligjshëm.
- Prandaj, dëshmitë e dy dëshmitarëve ekspertë nuk hedhin dritë të re në vlerësimin e vetëmbrojtjes.

⁷⁰ Proceverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 16 tetor 2014, faqe 17, versioni në gjuhën angleze;

⁷¹ Proceverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 16 tetor 2014, faqe 19, versioni në gjuhën angleze;

⁷² Proceverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 16 tetor 2014, faqe 20, versioni në gjuhën angleze;

103. Sa i përket rikonstruktimit të vendit të ngjarjes - aspekti i dytë i cekur në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit - Trupi gjykues konsideron sikurse më poshtë:
104. Në Aktvendimin e saj Gjykata e Apelit ka vlerësuar se Trupi gjykues i rigjykimit “tërësisht kishte dështuar që të justifikojë propozimet e Gjykatës së Apelit, lidhur me mundësinë e rikonstruktimit të vendit të ngjarjes”.
105. Kjo nuk është e saktë, pasi që Trupi gjykues i rigjykimit të parë kishte marr qëndrim të qartë në këtë çështje: ata kanë hedhur poshtë kërkesën nga mbrojtja për të dyja, rikonstruktimin dhe vizitën e vendit të ngjarjes dhe ka përpunuar arsyet për këtë në Aktvendimin e tyre Gojor nga data 17 qershor 2013.⁷³
106. Sido që të jetë, duke marr parasysh udhëzimin nga Gjykata e Apelit, Trupi gjykues ishte i detyruar që të e rivlerësojë aspektin brenda procedurave aktuale.
107. Bazuar në nenin 253, paragrafin 4, të KPK-së, “rikonstruktimi duhet që të bëhet duke i rikrijuar faktet apo situatat nën rrethanat mbi të cilat, mbi bazat e dëshmive të marra ngjarjet kanë ndodhur”.
108. Rikonstruktimi i vendit të ngjarjes është një proces logjik i organizuar i arritur në përfundimet e mbështetura shkencore rreth ngjarjeve që e rrethojnë krijimin e vendit të ngjarjes të jetë ekzaminuar. Rikonstruksioni i vendit të ngjarjes kërkon që të analizohen pikat e dëshmive - të dyja të depozituara dhe të larguara - dhe të zbatohet një metodë logjike që do të rezultojë në përcaktimin e sekuencave të ngjarjes që, nga ana tjetër, çon tek një fotografi e qartë se çka ka ndodhur gjatë kryerjes së krimit.⁷⁴

⁷³ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor 17 qershor 2013, faqet 8-9, versioni në gjuhën angleze;

⁷⁴ Shiko Filozofinë e Rikonstruktimit të Vendit të Ngjarjes, nga Michael A. Knox, 06 qershor 2012;

109. Bazuar tek autori i njëjtë, rikonstruksioni i suksesshëm i vendit të ngjarjes duhet të merr parasysh të gjitha dëshmitë në shfrytëzim, fizike, apo dëshmuese apo dokumentuese. Dëshmitë e konsideruara duhet që të përfshijnë, por jo të kufizuara tek:
1. Dëshmitë fizike;
 2. Deklaratat e viktimave;
 3. Deklaratat e dëshmitarëve;
 4. Deklaratat e të dyshuarve;
 5. Dëshmitë motivuese/të sjelljes/psikologjike;
 6. Dëshmitë dokumentuese;
 7. Ndjenja e përbashkët.
110. Në rastin tonë, dëshmitë e vetme fizike janë raportet policore dhe fotografitë që tregojnë pozitën e motoçikletës së të pandehurit në rrugë. Sido që të jetë, kjo madje nuk është qëllimi i lidhjes. As pozita e palëve para fillimit të konfliktit. I pandehuri duke e ngarë në drejtim të Mitrovicës, në anën e djathtë të rrugës dhe pala e dëmtuar duke qëndruar në anën e kundërt të rrugës.
111. Nga kjo pikë dhe deri në fund të përleshjes ne nuk kemi dëshmi në mënyrë absolute se çka në të vërtetë kishte ndodhur, përveç nga deklarata e të pandehurit. Në mënyrë absolute nuk ka dëshmitarë të drejtpërdrejt që mund të dëshmojnë se si kishin filluar ngjarjet apo se si ishin zhvilluar. As ndonjë dëshmi të depozituar në terren nuk ishte mbledhur apo dokumentuar, të jenë ato gjurmët e këmbëve, njollat e gjakut, shenja të tjera apo degë të thyera, që do të ndihmonin rikonstruksionin eventual. Për më shumë, vizita në vendin e ngjarjes ka treguar se vendi kishte ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme në ndërkohë.
112. Prandaj, për të administruar rikonstruksionin do të barazonte vënien në skenë versionin vetanak të të pandehurit të ngjarjeve. Ai tani më kishte paraqitur në detaje versionin e tij të ngjarjeve, para Gjykatës kur ai më herët kishte dhënë deklaratë dhe gjithashtu edhe gjatë vizitës së vendit të ngjarjes.

113. Trupi gjykues kishte vizituar vendin e ngjarjes vetëm që të ndërmerr të gjitha përpjekjet e mundshme, nën dritën e dëshmime në shfrytëzim, që të veprojë në pajtim me udhëzimet e Gjykatës së Apelit. Është vënë re se të dy veprimet hetimore - rikonstruksioni dhe vizita e vendit të ngjarjes janë të rregulluara nga neni 254, i KPK-së dhe dispozitat janë vëzhguar si duhet. Trupi gjykues, ka bërë të pamundurën e saj që të mbledhë, sa më shumë që është e mundur, të gjitha dëshmitë që do të mund të dëshmonin rastin të rëndësishëm. Veçantitë e terrenit janë vëzhguar, i pandehuri përsëriti versionin e tij të ngjarjeve, janë matur gjatësia e shpatit dhe e rrugës anësore gjithashtu.
114. Gjetjet e vendit të ngjarjes nuk sjellin asgjë të rëndësishme në këtë rast. Veçantitë e terrenit kanë ndryshuar shumë për katër vite që kanë kaluar që nga incidenti dhe nuk reflektojnë dëshmi të rëndësishme në dinamikën e përleshjes.
115. Procesverbalet e vendit të ngjarjes janë dhënë për palët dhe në seancën e datës 13 nëntor 2014, Prokuroria kishte disa komente të adresuara nga Trupi gjykues, gojarisht dhe me një Shtesë.⁷⁵ E rëndësishme është gjithashtu sjellja e të akuzuarit pas përleshjes.
116. Dëshmitari A. H.⁷⁶ deklaroi në deklaratën e tij se personi që qëndronte në këmbë kishte fytyrën e gjakosur dhe kishte një thikë në dorë të cilën e hodhi në drejtim të Shipolit. Si rrjedhojë, thika me të vërtetë nuk u gjet asnjëherë nga policia⁷⁷. Kjo dëshmon faktin se i akuzuari kishte për qëllim të heq duarsh armën dhe prandaj ishte i vetëdijshëm se kishte bërë diçka të paligjshme dhe përpiquej të mbulonte atë që kishte bërë.

⁷⁵ Shih Shtesën e Procesverbalit të Vizitës së Vendit të Ngjarjes dhe Procesverbalin e Shqyrtimit Kryesor, 13 gusht 2014, versioni në gjuhën angleze;

⁷⁶ Procesverbal i intervistës së dëshmitarit, 23 nëntor 2010, faqe 148, versioni në gjuhën angleze;

⁷⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 18 qershor 2013, faqe 13, versioni në gjuhën angleze;

117. I pandehuri po ashtu deklaroi se menjëherë pas zënkës e humbi vetëdijen; pasi erdh në vete, shikimin e kishte të turbullt dhe filloi të largohej nga vendi i ngjarjes në drejtim të rrugës së Zhabarit. Sipas të akuzuarit, gjëja e fundit që i kujtohej lidhur me palën e dëmtuar ishte kur të dy rrotulloheshin së bashku teposhtë⁷⁸. Megjithatë, më vonë në deklaratën e tij, i akuzuari deklaroi se ai nuk kishte frikë se pala e dëmtuar do ta ndjekë atë, dhe ai “e dinte se ai kishte mbetur në tokë”⁷⁹. I akuzuari nuk ishte i shqetësuar se pala e dëmtuar do ta ndjekë atë apo se do të paraqiste rrezik në ndonjë formë. Në këndvështrimin e trupit gjykues kjo mund të shpjegohet vetëm me faktin se i njëjti ka qenë shumë i vetëdijshëm për seriozitetin e plagës së shkaktuar viktimës dhe faktin se viktima ka qenë i palëvizshëm në tokë.
118. Në fakt i pandehuri rezultoi të jetë më i shqetësuar për gjërat e tij materiale se sa për ndjekjen nga viktima. Pas incidentit i akuzuari u tregua plotësisht i gjakftohtë kur ai kërkoi nga policia nëse mund të bënte një telefonatë dhe kur ai kërkoi po ashtu nga ata që të mos konfiskohet motori.⁸⁰ Për dallim, menjëherë pas incidentit pala e dëmtuar ishte i hutuar dhe kur transportohej në spital ai vazhdonte të pyeste se çka ka ndodhur⁸¹.
119. Është e rëndësishme po ashtu se i akuzuari as në vendin e ngjarjes dhe as më vonë, nuk ka raportuar asnjëherë se ishte sulmuar nga viktima apo se viktima kishte filluar rrahjen. Është tepër e pazakonshme që një person i cili sapo është sulmuar nuk do t'i deklaronte këtë gjë policisë të cilët kishin arritur në vendin e ngjarjes. Për më tepër, ai nuk i raportoi asgjë asnjë nga autoriteteve as ditën e nesërme pas incidentit, kur ai kuptoi se viktima kishte vdekur⁸². Në fakt ai nuk i tha policisë, personelit mjekësor apo punonjësve të burgut në Dubravë asgjë lidhur me sulmin⁸³, dhe vetëm gjatë

⁷⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor 29 korrik 2013, faqe 20;

⁷⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor 29 korrik 2013, faqe 31;

⁸⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor 20 qershor 2013, faqe 23;

⁸¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor 20 qershor 2013, faqe 4;

⁸² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 29 korrik 2013, faqe 30;

⁸³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 29 korrik 2013, faqe 20 dhe 21;

procedurës gjyqësore ai filloi të përdorë këtë linjë të mbrojtjes. Kjo vërteton besimin e trupit gjykues se deklarimi për vetëmbrojtje është i trilluar.

120. Trupi gjykues më tej konstaton se historiku i marrëdhënieve në mes viktimës dhe të akuzuarit për më tepër mbështet përfundimin se i akuzuari nuk ka vepruar në vetëmbrojtje por ka qenë ai i cili e ka ndër marr sulmin. Gjatë tërë procedurës nuk janë siguruar informata se përse do të sulmonte **M.D.** të akuzuarin. I akuzuari vetë nuk ishte në gjendje të shpjegojë arsyen rreth asaj pse **M.D.** papritmas donte të sulmonte atë. Në deklaratën e tij ai përmend “Unë kurrë nuk kam besuar derisa ai më kapi për fyti...unë kurrë nuk kam menduar se një gjë e tillë do të na ndodhte neve”⁸⁴.
121. Nga ana tjetër, analiza e kësaj historie, siç u cek me të drejtë nga Prokurorja publike në fjalën e saj përfundimtare, shpalosë një motiv për sulmin e të akuzuarit ndaj të ndjerit **M.D.**.
122. Më 24 gusht 2010, më pak se 3 muaj para sulmit, viktima ushtroi një ankesë në Policinë e Kosovës lidhur me kërcënimin e bërë ndaj tij nga i akuzuari. Ankesa, e lexuar në prova si pjesë e procesverbalit⁸⁵, shpalosë se viktima kishte frikë për sigurinë e tij. I akuzuari ishte i informuar për ankesën dhe ai vetë dha deklaratë në përgjigje të pretendimeve të bëra nga viktima. Kjo pasojë me një kontroll ku policisë konfiskoi një armë nga i akuzuari. Ishte prandaj i akuzuari i cili kishte arsye, e keqësuar nga çështja e kabllor elektrike dhe nga ankesa e bërë ndaj tij në polici, të sulmojë viktimën dhe jo e kundërta.
123. Për më tepër, në vendin e ngjarjes, siç u dëshmuar nga oficeri i policisë **S.S.**, i akuzuari në mënyrë specifike ishte pyetur se çfarë ishte arsyeja dhe ai u përgjigj se

⁸⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 29 korrik 2013, faqe 31;

⁸⁵ Memorandum zyrtar i policisë së Kosovës, 24 gusht 2010, rasti nr. 2010-BC-1284, dosja e prokurorit 1;

ishite rreth një kabloje elektrike⁸⁶. I pandehuri e ndryshoi deklaratën e tij rrënjësisht para Trupit gjykues, ku vazhdimisht deklaronte se çdo çështje e kaluar në mes tij dhe palës së dëmtuar ishte zgjidhur shumë kohë më parë, dhe se mosmarrëveshjet në të kaluarën janë zgjidhur në mënyrë të civilizuar⁸⁷. Megjithatë, në bazë të provave të cilat u përmenden më herët, trupi gjykues gjen deklaratën e të pandehurit kontradiktore dhe të pasinqertë.

124. Për më shumë, viktima kishte shumë frikë nga i akuzuari dhe përpara incidentit ai vazhdimisht i shmangej atij. Kjo ishte konfirmuar përmes dëshmisë së djalit të viktimës **Z. D.** Ky i fundit dëshmoi se babai i tij një kohë të gjatë frikësohej të largohej nga shtëpia, frikësohej nga takimi me të akuzuarin, duke pritur që i akuzuari do ta sulmojë atë⁸⁸.
125. Për të përfunduar, në bazë të provave materiale, përfshirë provave të Mjekësisë Ligjore dhe duke pasur parasysh kundërthëniet e përmendura dhe pasaktësitë në deklaratat e të pandehurit trupi gjykues është i bindur se i akuzuari nuk ka vepruar në vetëmbrojtje kur e ka goditur me thikë viktimën, por ai në fakt ishte personi i cili filloi sulmin.
126. Duke marrë parasysh këtë, mbrojtja ligjore e mbrojtjes së nevojshme sipas nenit 8 të KPK është e përjashtuar.
127. Trupi gjykues tani kthehet të vlerësojë nëse elementet subjektive (e ashtuquajtura *mens rea*) e të akuzuarit, janë vërtetuar.
128. Sipas nenit 11 paragrafi 91) të KPK, personi është përgjegjës penalisht nëse ai ose ajo është mendërisht i/e aftë dhe është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Në

⁸⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 shkurt 2012, faqe 4 dhe 5;

⁸⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 29 korrik 2013, faqe 24, 25, 26, 32, 33 dhe 34;

⁸⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 17 qershor 2013, faqe 18;

pajtim me dispozitën e njëjtë, një person është fajtor për kryerjen e një vepre penale kur ai ose ajo kryejnë një vepër penale me dashje apo nga pakujdesia.

129. E para, nuk ka dyshim për sa i përket faktit se i akuzuari ka qenë plotësisht i aftë mendërisht kur ka kryer veprën. Asgjë në dosje të lëndës nuk sugjeron ndryshe dhe nuk është ngritur asnjë kundërshtim i tillë nga mbrojtja.
130. E dyta, i akuzuari, kur ka kryer krimin, ka vepruar me dashje.
131. Vepra penale mund të kryhet me dashje të drejtpërdrejt ose eventuale. Personi vepron me dashje të drejtpërdrejt kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj. Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe e pranon shkaktimin e saj.
132. Trupi gjykues arriti në përfundim se i pandehuri ka vepruar me *animus necandi*. Qëllimi për të vrarë, që është element i vullnetshëm i futur në ndërgjegjen e personit, mund të nxjerrët vetëm nga provat rreth sjelljes së vrojtuar të pandehurit. Elementet provuese të prekshme për zbulimin e qëllimit të personit janë, në mes tjerash: sjellja e tij përpara, gjatë dhe pas sulmit, që përbëjnë siç u tha, shprehjet kërcënuese, ndihma dhënë viktimës etj.; arma apo instrumenti i përdorur gjatë sulmit; rajoni i trupit i shënuar gjatë sulmit; numri i goditjeve; dhe në përgjithësi ndonjë informatë tjetër që mund të rezultojë nga e veçanta e rastit.
133. I akuzuari përdori një thikë për të goditur viktimën. Ai e goditi viktimën tetë herë; Katër goditje janë bërë në gjoks në rajonin e zemrës, që tregon për qëllimin e tij të privojë viktimën nga jeta. I akuzuari ka shkaktuar goditjet në rajonin e zemrës dhe dihet në përgjithësi se goditjet në zemër kanë më së shumti gjasa të rezultojnë me vdekje. I akuzuari nuk e ka goditur viktimën vetëm një herë por vazhdimisht brenda

sekondave. Ai ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për potencialin e pasojave të veprimit të tij. Trupi gjykues po ashtu vë re sjelljen e të pandehurit menjëherë pas sulmit, pra që ka qenë i përmbajtur dhe i qetë dhe nuk e ka perceptuar viktimën më si një kërcënim. Kjo dëshmohet me faktin se ai nuk ka vepruar në ndonjë mënyrë irracionale kur ka sulmuar viktimën dhe se ka qenë plotësisht i vetëdijshëm dhe ka pranuar pasojat e sulmit të tij.

134. Bazuar në atë që u cek më lartë, trupi gjykues ka gjetur të akuzuarin përgjegjës penalisht për kryerjen e veprës penale të Vrasjes sipas nenit 146 të KPK. I akuzuari e ka kryer veprën me dashje indirekte.

VII. DËNIMI I SHQIPTUAR

135. Gjatë shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit të shpallur fajtor për një krim të caktuar, trupi gjykues duhet të ketë ndërmend edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit - do të thotë të ndalojë aktivitete të rrezikshme shoqërore duke përmbajtur të tjerët nga kryerja e veprave të njëjta, edhe qëllimin specifik - do të thotë parandalimi i kryerësit nga përsëritja e veprës. Sipas nenit 34 të KPK: "Qëllimet e dënimit janë: 1) Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij dhe 2) të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale". Dy qëllime tjera të dënimit që referohen zakonisht nga ekspertët e kriminologjisë dhe penologjisë janë ndëshkimi dhe rehabilitimi.
136. Prandaj, Trupi gjykues duhet të merr parasysh të gjitha këto qëllime kur e përcakton dënimin.

137. Po ashtu, më 01 janar 2013 ka hyrë në fuqi Kodi i ri Penal. Prandaj, Trupi gjykues duhet të konsiderojë parimin e pakundërshtueshëm të *lex mitior*⁸⁹, trupi gjykues duhet që *in concreto* të ketë parasysh se cili ligj do të jetë më i favorshëm për të pandehurit gjatë llogaritjes së dënimit. Siç u cekë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *lex mitior* është ai i cili është më i favorshëm për të pandehurin, duke marrë parasysh karakteristikat e tij ose të saj, natyrën e veprës dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra⁹⁰. Prandaj, *lex mitior* duhet të konstatohet *in concreto*⁹¹.

VII.1 Llogaritja e dënimit sipas KPK-së të vjetër

138. Vepra penale e Vrasjes sipas nenit 146 të KPK parasheh dënimin me më së paku pesë vjet burgim.

139. Lidhur me rregullën e përgjithshme të dënimit me burgim, neni 38 paragrafi (1) i KPK-së thotë se “Dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë ditë e as më i gjatë se njëzet vjet”.

140. Lartësia e zbatueshme e dënimit për veprën penale të Vrasjes është, prandaj, nga pesë deri në njëzet vjet burgim.

141. Sipas nenit 64(1) të KPK-së: “Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (*rrethanat lehtësuese dhe rënduese*) dhe sidomos shkallën e përgjegjesisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, sjelljen e

⁸⁹ Shih lëndën *Scoppola nr. 2*, GJEDNJ;

⁹⁰ *Scoppola vs Italia (nr.2) nr. 10249/03, para 109, 17 shtator 2009; Maktouf dhe Damjanovic v Bosnja dhe Hercegovina, mendime të ndara, faqe 43;*

⁹¹ Shih më lartë, *Maktouf dhe Damjanovic v Bosnja dhe Hercegovina, faqe 44;*

mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit, dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit.

142. Trupi gjykues e konsideron se sulmi i të akuzuarit ndaj fqinjit të tij është një akt kriminal posaçërisht të rëndë. Mënyra të tilla të zgjidhjes së konflikteve në mes njerëzve në komunitete nuk mund të tolerohen dhe dënimi i shqiptuar duhet të reflektojë këtë.
143. Trupi gjykues, gjatë përcaktimit të dënimit ka marrë po ashtu parasysh rrethanat si në vijim si rrethana lehtësuese: moshën e shtyrë të të akuzuarit, shëndetin e dobët të të akuzuarit, faktin që i akuzuari nuk ka dosje kriminale.
144. Duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cekura më lartë, trupi gjykues e dënoi të akuzuarin me 8 /tetë/ vjet burgim për veprën penale të Vrasjes në shkelje të nenit 146 të KPK.

VII.2 Llogaritja e dënimit sipas KPK-së të ri

145. Lidhur me veprën penale të Vrasjes, neni 178 i KPK të ri parasheh po ashtu dënim jo më pak se pesë vjet.
146. Megjithatë, neni 45 paragrafi (1) i KPK të ri thotë se “Dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë ditë e as më i gjatë se njëzet e pesë vjet”.
147. Lartësia e zbatueshme e dënimit për veprën penale të “Vrasjes” është, prandaj, nga pesë deri në njëzet e pesë vjet burgim.

148. Në bazë të të njëjtave rrethana lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues, prandaj, do të kishte shqiptuar ndaj të pandehurit dënimin prej dhjetë (10) vjet burgim, për Vrasje.

VII.3 Lex mitior dhe llogaritja përfundimtare

149. Trupi gjykues konsideroi se përfundimi më i favorshëm për të pandehurin do të ishte arritur in concreto duke zbatuar KPK-në e vjetër.

150. Koha e kaluar në paraburgim, në me të 22 nëntorit 2010 dhe 11 nëntorit 2011, dhe në mes të 27 marsit 2012 dhe 30 korrikut 2013, dhe koha e kaluar nën arrest shtëpiak, nga 11 nëntori 2011, deri më 27 mars 2012, dhe nga 30 korriku 2013, deri më sot është janë kredituar , në pajtim me nenin 73, paragrafëve 1 dhe 4, të KPK-së.

AKUZA PER ARMË:

151. Sikurse është paraqitur më lart, me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, data, 26 mars 2013, I akuzuari është dënuar me 1 (një) vit burg për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, neni 328, paragrafi 2, i KPK-së.

152. Duke u bazuar në nenin 12 dhe nenin 3, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2.5, të Ligjit mbi Amnistinë (Ligji nr. 04/L-209), data 11 korrik 2013, e shpallur me dekret No. DL-051-2013, data, 17 shtator 2013, e cila ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, i pandehuri është përjashtuar nga ekzekutimi i dënimit prej 1 (një) viti burgim e zbatuar nga Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, data, 26 mars 2013, për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, neni 328, paragrafi 2, i KPK-së. – (Akuza 3).

I. SHPENZIMET DHE TË TJERA

153. Për shkak të gjendjes së tij të varfër ekonomike, i akuzuari duhet të kompensojë vetëm 400 (katërqind) Euro si pjesë të shpenzimeve të procedurës penale por lirohet nga obligimi për të kompensuar pjesën e mbetur sipas nenit 102 paragrafët (1) dhe (4) të KPK.

Roxana Comsa

Kryetare e trupit gjykues e EULEX-it

Nuno Madureira

Anëtar i trupit gjykues

Gjyqtar i EULEX-it

Arkadiusz Sedek

Anëtar i trupit gjykues

Gjyqtar i EULEX-it

Vera Manuello

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur kopja e aktgjykimit u është dorëzuar atyre, në pajtim me nenin 398 paragrafi (1) të KPPK.

